



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 180

**Tiranë – E mërkurë, 11 tetor 2017**

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 534, datë 4.10.2017	Për miratimin e raportit të nëntë, të dhjetë, të njëmbëdhjetë kombëtar periodik për zbatimin e konventës ndërkombëtare të OKB-së, “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor” ..... 9103

**VENDIM**

Nr. 534, datë 4.10.2017

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË  
NËNTË, TË DHJETË, TË  
NJËMBËDHJETË KOMBËTAR  
PERIODIK PËR ZBATIMIN E  
KONVENTËS NDËRKOMBËTARE TË  
OKB-SË, “PËR ELIMINIMIN E TË  
GJITHA FORMAVE TË DISKRIMINIMIT  
RACOR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 25, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 7768, datë 9.11.1993, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën ndërkombëtare, “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor””, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Miratimin e raportit të nëntë, të dhjetë, të njëmbëdhjetë kombëtar periodik për zbatimin e konventës ndërkombëtare të OKB-së, “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Edi Rama**

**Komiteti për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial (CERD)**

**SHQYRTIMI I RAPORTEVE  
DËRGUIAR NGA SHTETET PALË, NË  
MBËSHTETJE TË NENIT 9 TË  
KONVENTËS PËR ELIMINIMIN E TË  
GJITHA FORMAVE TË DISKRIMINIMIT  
RACOR  
SHQIPËRIA  
RAPORTI PERIODIK KOMBËTAR  
CIKLI IX–XI**

Gusht, 2017

**I. HYRJE**

1. Republika e Shqipërisë ka aderuar në konventën “Për eliminimin e të gjitha formave të

diskriminimit racor”, me ligjin nr. 7768, datë 9.11.1993. Komiteti mori në shqyrtim raportet e ciklit V-VIII (CERD/C/ALB/5–8), paraqitur në një dokument, në mbledhjet e tij të 2110-të dhe 2111-të (CERD/C/SR. 2110 dhe CERD/C/SR. 2111), mbajtur më 22 dhe 23 gusht 2010, në mbledhjen e tij të 2125-të (CERD/C/SR. 2125), të mbajtur më 1 shtator 2011. Në raportimin e kaluar, komiteti përshëndeste në tërësi dorëzimin e raporteve, sikurse dhe rinisjen e dialogut të mbajtur me delegacionin e nivelit të lartë dhe përgjigjet me gojë dhënë pyetjeve të anëtarëve të Komitetit.

2. Raporti aktual periodik kombëtar, paraqitur në zbatim të nenit 9 të konventës “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor” (CERD), u hartua në përputhje me udhëzimet mbi formën dhe përmbajtjen e raporteve që duhen paraqitur nga shtetet palë, për periudhën kohore 2011–aktualisht. Raporti përmban informacion mbi zbatimin e dispozitave të Konventës dhe rekomandimeve të komitetit “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor”, bazuar dhe në vërejtjet përmbyllëse (shtator 2011). Vend të rëndësishëm zënë progresi i arritur në aspektin ligjor dhe institucional, politikat e hartuara dhe vështirësitë/sfidat për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racial.

3. Duke konsideruar respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si një ndër prioritetet kryesore, qeveria shqiptare është e angazhuar në përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare, që rrjedhin nga konventat mbi të drejtat e njeriut. Mbështetur në urdhrin e Kryeministrit nr. 112, datë 5.3.2014, “Për ngritjen e grupit ndërministror të punës mbi hartimin dhe pjesëmarrjen në shqyrtimin e raporteve në kuadër të konventave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut”, Ministria e Punëve të Jashtme koordinon procesin e përgatitjes së raporteve kombëtare mbi zbatimin e konventave për të drejtat e njeriut, përfshirë edhe raportin në kuadër të kësaj konvente, në bashkëpunim me institucionet shtetërore dhe institucionet e pavarura.

4. Ky raport është hartuar si rezultat i koordinimit të punës dhe përfshirjes së institucioneve shtetërore, sipas fushave të kompetencës së tyre mbi çështjet që trajton kjo Konventë. Raporti është përgatitur në bashkëpunim me institucionet qendrore (Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Drejtësisë,



Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Zhvillimit Urban dhe Ministria e Kulturës,) dhe institucioneve të pavarura (Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokati i Popullit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve).

## II. INFORMACION MBI ZBATIMIN E NENEVE TË KONVENTËS DHE REKOMANDIMET E KOMITETIT TË EKSPERTËVE TË KONVENTËS, MBI PROGRESIN E ARRITUR GJATË PERIUDHËS 2011 – AKTUALISHT INFORMACION MBI NENE SPECIFIKE

Neni 1. Informacione në lidhje me përcaktimin dhe parashikimet ligjore rreth përkufizimit të diskriminimit

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë sanksionon parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit. Në nenin 18 parashikohet: “Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit dhe askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore”. Neni 16/1 i Kushtetutës parashikon se të drejtat e liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë, vlejnë njëjloj edhe për të huajt, edhe për personat pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Ligji nr. 10221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikon dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën etj. (neni 1). Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi e përkufizon diskriminimin si: çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi (neni 3).

3. Nga praktika e zbatimit të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, vit pas viti po vihet re një ndërgjegjësim më i madh i publikut të gjerë dhe grupeve të veçanta mbi mjetet ligjore për mbrojtjen nga diskriminimi. Kjo gjë reflektohet edhe në rritjen e numrit të ankesave të regjistruara dhe zbatimin e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”

edhe në gjykata. Bazuar në raportin vjetor të Komisionerit për Mbrojtje nga Diskriminimi (KMD), nga 15 ankesa të marra në vitin 2011, numri i ankesave ka shkuar në 172 në vitin 2014. 164 nga 172 ankesat e vitit 2014 janë me pretendimin e diskriminimit mbi baza racore. Por, edhe pse numri i ankesave ka shënuar rritje, ndërgjegjësimi i popullsisë mbetet ende një prioritet për KMD-në.<sup>1</sup>

Neni 2. Informacione lidhur me masat ligjore dhe institucionale<sup>2</sup> kundër diskriminimit racial

4. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 18 të saj ka sanksionuar parimin e barazisë para ligjit, duke parashikuar se askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha etj. Pra, Kushtetuta dhe ligji jo vetëm nuk njohin asnjë kufizim ose privilegj në të drejtën dhe detyrat e shtetasve për shkaqet më sipër, por çdo veprim privilegji apo pabarazie në shkelje të këtyre të drejtave është antikushtetues dhe dënohet sipas ligjit, përkatësisht me nenet 253/1, 265/2, 266/3 e vijues të Kodit Penal.

5. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi parashikon mbrojtje nga diskriminimi për shkaqe, si: raca, etnia, gjuha, ngjyra dhe parashikon disa forma të diskriminimit, si: diskriminimi i drejtpërdrejtë, i tërthortë, diskriminim për shkak të shoqërimit, udhëzimi për të diskriminuar, mohimi i një përshtatjeje të arsyeshme, viktimizim (neni 3). Mbrojtja nga diskriminimi sipas këtij ligji garantohet nga çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. Ky ligj parashikon mbrojtjen nga diskriminimi në disa fusha të jetës publike, si: të mirat dhe shërbimet, fusha e punësimit dhe e arsimit.

6. Kuadri ligjor dhe nënligjor që rregullon veprimtarinë e Policisë së Shtetit është përmirësuar me qëllim respektimin e të drejtave të njeriut dhe

<sup>1</sup><http://kmd.al/skedaret/1427975691Raporti%20Vjetor%202014.pdf>

<sup>2</sup> Informacion lidhur dhe me rekomandimin 9 të Komitetit.



në veçanti të personave që u privohet liria në ambientet e policisë. Kuadri ligjor përbën një garanci për respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, trajtimin në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, gjuhës, besimit, etnisë, bindjeve politike, fetare, filozofike, orientimit seksual, gjendjes ekonomike, arsimore, sociale, përkatësisë prindërore.

7. Konkretisht, në ligjin “Për Policinë e Shtetit” nr. 108, datë 31.7.2014, përcaktohen parimet bazë që udhëheqin veprimtarinë e Policisë dhe në veçanti: mosdiskriminimi dhe respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ligji për Policinë e Shtetit parashikon detyrimin e punonjësve të policisë për respektimin e Kushtetutës dhe legjislacionit dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, konkretisht: “Punonjësi i policisë kryen me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim dhe në përputhje me ligjin, detyrat e tij”. Ky ligj garanton bashkëpunimin e policisë me komunitetin për ushtrimin e lirive dhe të drejtave të personave. Gjithashtu, ligji parashikon bashkëpunimin e policisë me shoqërinë civile për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave edhe lirive themelore të njeriut.

8. Ligji parashikon rastet ligjore të shoqërimit të personave, koha e mbajtjes dhe e trajtimit si të shoqëruar (jo më shumë se 10 orë), të drejtat lidhur me njoftimin në gjuhën që ata kuptojnë, lidhur me shkaqet e shoqërimit, vënia në dijeni se nuk ka detyrim që të bëjë deklaratë, të drejtën e komunikimit me person të besuar apo avokat (nenet 109, 122). Gjithashtu parashikohet detyrimi i policisë për të evidentuar dhe administruar të dhënat për personat e shoqëruar dhe në përfundim të shoqërimit hartohet një procesverbal për veprimet e kryera dhe marrja dijeni nga ana e personit të shoqëruar. Në nenin 115 është sanksionuar e drejta që kanë personat e shoqëruar, ndaluar dhe të arrestuar për të paraqitur kërkesë/ankesat lidhur me qëndrimin, trajtimin, kushtet e trajtimit, sjelljet/qëndrimin e personelit policor, shkeljet dhe abuzimet që kryhen ndaj të drejtave të tyre. Në nenin 133 përcaktohen rregullat për përdorimin e forcës nga policia.

#### *Në fushën e punësimit*

9. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi (neni 14) parashikon detyrat e Këshillit të Ministrave, ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (sot ministrit të Mirëqenies Sociale dhe

Rinisë) dhe ministrit të Brendshëm (sot ministri i Punëve të Brendshme) për marrjen e masave me karakter pozitiv për të luftuar diskriminimin në lidhje me të drejtën për punësim, konkretisht:

- Rritjen e ndërgjegjësimit për këtë ligj të punëmarrësit dhe punëdhënësit, ndër të tjera duke dhënë informacion mbi këtë ligj.

- Vendosjen e politikave të posaçme dhe të përkohshme, në bazë të shkaqeve të përmendura në nenin 1 të këtij ligji, me qëllim nxitjen e barazisë, në veçanti midis burrit dhe gruas, si dhe personave me aftësi të plota fizike dhe atyre me aftësi të kufizuara. Në nenin 15 parashikohet:

- Mundësia për t'u ankuar ndaj një sjelljeje diskriminuese në fushën e punësimit jo vetëm ndaj Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe në gjykatë, por edhe ndaj institucioneve të veçanta të ngritura në sektorë të ndryshëm të punësimit.

- Punëdhënësi duhet të marrë vendim për ankesën e punëdhënësit për diskriminim.

10. Me VKM-në nr. 191, datë 2.4.2014, janë bërë disa ndryshime dhe shtesa në rregulloren e personelit të Policisë së Shtetit, ku u përcaktua që “Minimalisht 2% e kandidatëve që pranohen në polici të jenë nga minoritetet dhe grupet etno-kulturore”.

#### *Në fushën e strehimit*

11. Në zbatim të ligjit 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, të ndryshuar, të planit të veprimit të strategjisë “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së komunitetit rom dhe egjiptian”, të rekomandimeve të Komisionit Evropian për Shqipërinë, si edhe të programit të “Granteve të vogla”, Ministria e Zhvillimit Urban, që nga viti 2014 dhe në vazhdim, ka zbatuar projektin “Për përmirësimin e kushteve të banimit të komunitetit rom dhe egjiptian”. Në këtë kuadër, janë miratuar termat e referencës për projekte të përmirësimit të kushteve të banimit të komuniteteve rom dhe egjiptiane, të cilat u janë dërguar të gjitha njësisve të qeverisjes vendore për të paraqitur projektet e tyre.

12. Prej vitit 2014, Ministria e Zhvillimit Urban (MZHU) financoi fondin prej 63,754,473 lekë<sup>3</sup> dhe përfitues kanë qenë rreth 340 familje të komunitetit rom dhe egjiptian në 4 njësi të qeverisjes vendore, konkretisht:

<sup>3</sup> Rreth 500.000 euro.



- Bashkia Lushnjë hartoi dhe depozitoi pranë MZHU-së projektin “Ndërhyrje emergjente në lagjen e romëve, lagja “Saver”, Lushnjë”, punimet e të cilit përfunduan në dhjetor 2014. Vlera e financuar ishte 29,330,889 lekë. Nga ky projekt përfituan 22 familje nga rikonstruksioni i banesave dhe rreth 150 familje nga ndërtimi e kanalizimi i ujërave të zeza dhe ujësjellësit.

- Komuna Otlak hartoi një projekt me dy faza, i cili përfundoi në dhjetor 2014. Nga ky projekt përfituan direkt 24 familje dhe indirekt 100, në total 124 familje romë. Faza e parë e projektit “Rikonstruksioni i banesave të komunitetit rom, ndërhyrje në infrastrukturë dhe në kanalizimet e ujërave të zeza, në fshatin Moravë, komuna Otlak”, me vlerë 11,014,844 lekë. Nga ky projekt përfituan 19 familje nga rikonstruksioni i banesave (përfitim direkt) dhe rreth 50 familje nga ndërhyrja në rrjetin e kanalizimeve të ujërave të zeza (përfitim indirekt). Faza e dytë e projektit “Rikonstruksioni i banesave të komunitetit rom, ndërhyrje në infrastrukturë dhe kanalizime të ujërave të zeza, në fshatin Moravë”, me vlerë 9,192,610 lekë. Nga ky projekt përfituan 5 familje nga rikonstruksioni i banesave dhe rreth 50 familje nga ndërtimi i kolektorit kryesor për kanalizimin e ujërave të zeza.

- Bashkia Lezhë hartoi projektin me titull “Rikonstruksioni i 36 shtëpive të komunitetit rom dhe egjiptian në lagjen “Skënderbeg”, me vlerë 9,426,848 lekë, që përfundoi në dhjetor 2014 dhe nga zbatimi i të cilit u rikonstruktuan 36 banesa romë.

- Bashkia Përmet hartoi projektin me titull “Ndërhyrje emergjente në banesat e komunitetit egjiptian, Përmet”, me vlerë 4,789,282 lekë për rikonstruksionin e 8 banesave egjiptiane. Projekti përfundoi në dhjetor 2014.

13. Me vendimin nr. 405, datë 1.6.2016, të Këshillit të Ministrave u miratua për herë të parë Strategjia e Strehimit Social 2016–2025, e shoqëruar me një plan veprimi konkret të detajuar, e cila nxori në pah situatën reale të strehimit, identifikoi nevojat për të mbështetur këtë sektor në kushtet e reja të reformës administrative-territoriale, si dhe diktoi nevojën e një ligji të ri.

14. Në prill të vitit 2016 u miratua nga Këshilli i Ministrave projektligji “Për strehimin social”<sup>4</sup>. Ky projektligji fillimisht u konceptua si një ndryshim i

ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, i ndryshuar, i cili tashmë nuk iu përgjigjet kushteve, si dhe politikave sociale. Nga ndryshimet e bëra gjatë hartimit, si dhe shtesat, ligji i sipërcituar u prek në 80% të tij. Kjo e bëri të nevojshëm hartimin e një ligji të ri. Ky projektligji synon krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përbalueshëm, për një jetesë të sigurt, me dinjitet dhe në paqe duke u mbështetur në aftësitë paguese të individëve dhe familjeve që kanë nevojë për strehim dhe që kanë nevojë për ndihmën e shtetit.

15. Projektligji “Për strehimin social” ka për qëllim që të mundësojë një qasje të përshtatur dhe për personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit, fëmijët dhe grupet e tjera, duke lehtësuar shkallën e plotësimit të nevojave të veçanta të strehimit të këtyre grupeve. Në planifikimin e zonave të banimit dhe programeve të strehimit parashikohet që nga shteti duhen bërë përpjekjet maksimale për të respektuar traditat dhe kulturat e ndryshme të komuniteteve dhe grupeve të veçanta. Qëllimi i ligjit është që të krijojë mundësi për akses në strehim të përshtatshëm dhe të përbalueshëm për familjet në nevojë. Ligji nevojitet të marrë në vëmendje masat konkrete me qëllim promovimin, mbrojtjen dhe sigurimin e plotë dhe progresiv të kësaj të drejte.

16. Projektligji për strehimin është një bazë e mirë për zhvillimin e programeve të strehimit me kosto të përbalueshme për grupet në nevojë. Kombinimi i ligjit kundër diskriminimit dhe këtij ligji ofron, gjithashtu, mbrojtje nga diskriminimi në ndarjen e banesave dhe përmirësime të tjera strehimi për komunitetin rom dhe egjiptian.

17. Kreu i dytë i projektligjit sanksionon parimet kryesore mbi të cilat mbështeten politikat dhe programet e banesave sociale si:

a) parimi i sigurisë së qëndrimit (neni 5), duke ndaluar dëbimin në çdo rast dhe duke ofruar garanci për individët/familjet që preken nga procesi i zhvendosjes;

b) parimi i respektimit të kulturës, traditave të komuniteteve, ku njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë përgjegjësi për planifikimin e zonave të banimit dhe programeve të strehimit.

*Eliminimi i nxitjes së frymës dhe veprimeve diskriminuese*

<sup>4</sup> Miratuar me VKM-në nr. 311, datë 12.4.2017.



18. Në Kodin Penal parashikohen dispozita që dënojnë nxitjen e frymës diskriminuese, si më poshtë:

- Neni 50/j, ku parashikohet qartësisht se kryerja e një vepre penale për motive diskriminimi racor do të shërbejë si rrethanë rënduese në caktimin e dënimit.

- Neni 84/a parashikon: “Kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, që i bëhet një personi, nëpërmjet sistemeve kompjuterike, për shkak përkatësie etnike, kombësie, race apo feje, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet”.

- Neni 119/a parashikon: “Ofrimi në publik ose shpërndarja e qëllimshme publikut, nëpërmjet sistemeve kompjuterike, e materialeve me përmbajtje raciste ose ksenofobike përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet”.

- Neni 119/b parashikon: “Fyerja e qëllimshme publike, nëpërmjet sistemit kompjuterik, që i bëhet një personi, për shkak të përkatësisë etnike, kombësisë, racës apo fesë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet”.

- Neni 253<sup>5</sup>. Shkelja e barazisë së shtetasve, “Kryerja për shkak të detyrës e në ushtrim të saj, nga ana e punonjësit me funksion shtetëror apo në shërbim publik, të dallimeve mbi bazë origjine, seksi, gjendjes shëndetësore, bindjeve fetare, politike, të veprimtarisë sindikale ose për shkak të përkatësisë në një etni, komb, racë apo fe të caktuar, që konsiston në krijimin e privilegjeve të padrejta ose në refuzimin e një të drejte ose përfitimi që buron nga ligji, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet”.

- Neni 265<sup>6</sup>. Nxitja e urrejtjes ose grindjeve “Nxitja e urrejtjes dhe e grindjeve, për shkak të racës, etnisë, fesë ose orientimit seksual, si dhe përgatitja, përhapja ose ruajtja, me qëllim përhapjen e shkrimeve me përmbajtje të tilla, e kryer me çdo mjet ose formë, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet”.

- Neni 266. Thirrja për urrejtje nacionale (ndryshuar me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 42) 2 “Vënia në rrezik e paqes publike duke bërë thirrje për urrejtje kundër pjesëve të popullsisë,

duke i fyer ose shpifur për to, duke kërkuar përdorimin e dhunës ose të veprimeve arbitrare kundër tyre, dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet”.

19. Kuadri ligjor është plotësuar edhe me akte nënligjore në zbatim të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, si dhe janë miratuar edhe akte administrative të Policisë së Shtetit, konkretisht:

- “Tërheqje vëmendjeje”, nr. 7946/1, datë 25.11.2013, “Për parandalimin dhe eliminimin e sjelljeve/qëndrimeve që cenojnë dinjitetin për shkak të përkatësisë etnike”. Në këtë tërheqje vëmendje theksi vihet në: 1. Trajtimin e njëjtë, pa diskriminim dhe të barabartë të të gjithë qytetarëve nga ana e Policisë së Shtetit. 2. Vlerësimin dhe trajtimin e të gjitha ankesave, denoncimeve të bëra për keqtrajtme/abuzime apo shkelje të të drejtave të personave që u përkasin komunitetit rom dhe egjiptian. 3. Monitorimin dhe kontrollin e vazhdueshëm të aktivitetit të punës së personelit policor nga drejtuesit e shërbimeve policore, njësisive policore, strukturat qendrore të policisë dhe Drejtoria e Standardeve Profesionale. 4. Marrjen e masave disiplinore dhe, kur janë kushtet, dhe ato penale ndaj personelit policor përgjegjës që me veprime apo mosveprime ka shkelur/cenuar apo nuk kanë respektuar e garantuar të drejtat ligjore të personave. 5. Rritjen e bashkëpunimit me drejtues të shoqatave dhe organizatave të komunitetit rom dhe egjiptian për të shkëmbyer informacione që kanë të bëjnë me respektimin e të drejtave të këtyre komuniteteve.

- Rregullorja e Policisë së Shtetit<sup>7</sup>, ku pjesë e saj është edhe Kodi i Etikës së Policisë.

- Zbatimi i procedurave standarde të punës mbi rregullat teknike të shoqërimit në Polici<sup>8</sup>.

- Zbatimi i procedurës standarde mbi kontrollin e personave. Rishikimi dhe përmirësimi i procedurës standarde për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar, në ambientet e Policisë, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesave/ankesave të tyre<sup>9</sup>.

- Krijimi dhe vënia në përdorim e sistemit elektronik mbi hedhjen dhe administrimin e të dhënave për personat e shoqëruar dhe të

<sup>7</sup> Miratuar me vendim të ministrave (VKM), nr. 750, datë 16.9.2015.

<sup>8</sup> Miratuar me urdhrin nr. 308, datë 31.3.2016.

<sup>9</sup> Miratuar me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, nr. 440/3, datë 27.4.2017.

<sup>5</sup> Parashikuar si vepër penale me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 40.

<sup>6</sup> Ndryshuar neni me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 41.



ndaluar/arrestuar, i cili zbatohet në të gjitha njësitë policore.

Në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar janë hartuar, miratuar dhe vënë në zbatim procedura standarde të punës së policisë:

a) Procedura standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me urdhrin nr. 306, datë 31.3.2016, të drejtorit të Policisë së Shtetit;

b) Procedura standarde: “Njoftimi për paraqitje në polici”, miratuar me urdhrin nr. 373/1, datë 12.4.2017, të drejtorit të Policisë së Shtetit;

c) Procedura standarde: “Kontrolli i identitetit të personit”, miratuar me urdhrin nr. 373/2, datë 12.4.2017, të drejtorit të Policisë së Shtetit;

d) Procedura standarde: “Bashkëpunimi i Policisë me organizatat e shoqërisë civile (OSHC) për monitorimin e të drejtave të personave të shoqëruar, arrestuar/ndaluar, në ambientin e policisë”, miratuar me urdhrin nr. 428, datë 26.4.2017, të Drejtorit të Policisë së Shtetit;

e) Procedura standarde: “Përdorimi i forcës nga punonjësit e policisë dhe raportimi mbi përdorimin e saj”, miratuar me urdhrin nr. 538, datë 18.5.2017, të Drejtorit të Policisë së Shtetit;

f) Procedura standarde: “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me urdhrin nr. 440/3, datë 27.4.2017 të Drejtorit të Policisë së Shtetit;

g) Për parandalimin e diskriminimit, ushtrimit të dhunës fizike dhe psikologjike, keqtrajtimeve, torturës, gjatë shoqërimit, ndalimit/arrestimit të personave, gjatë marrjes në pyetje dhe trajtimit në ambientet e policisë zbatohen një sërë masash:

1. Tërheqje vëmendjeje nr. 972, datë 5.2.2014, “Për zbatimin me përpikëri të akteve ligjore dhe nënligjore dhe procedurave standarde të punës lidhur me arrestimin/ndalimin, kontrollin fizik dhe trajtimin e personave të arrestuar/ndaluar”.

2. Kryerja e inspektiveve dhe kontrolleve në strukturat e policisë edhe në nivel vendor, lidhur me përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga ligji për garantimin e të drejtave të njeriut pa diskriminim.

3. Kryerja e inspektiveve për raste të ngjarjeve të evidentuara apo ankesa, ndaj punonjësve të policisë. Për shkeljet dhe mangësitë e konstatuara fillon ecuria disiplinore për dhënien e masave

disiplinore ndaj punonjësve përgjegjës së Policisë, bazuar në rregulloren e disiplinës.

20. Nga ana e strukturave të Policisë së Shtetit punohet në vazhdimësi për evidentimin e të gjitha rasteve të fjalimeve për urrejtje, qofshin këto për arsye të përkatësisë etnike, kombësisë, racës etj., gjatë viteve 2011 e në vazhdim kanë evidentuar 5 raste të veprës penale “Nxitja e urrejtjes ose e grindjeve”, neni 265 i Kodit Penal, i ndryshuar.

Neni 5. Masat ligjore dhe institucionale mbi mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore

21. Kushtetuta parashikon një sërë dispozitash mbi garantimin e ushtrimit të të drejtave dhe lirive themelore për të gjithë personat pavarësisht nga gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. Gjithashtu, Kushtetuta garanton se çdo individ, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Nga ana tjetër, kadri ligjor dhe nënligjor sipas fushave synon garantimin dhe zbatimin në praktikë të të drejtave të njeriut (të drejtat e grave, fëmijëve, personave me aftësi të kufizuara, të drejtat e pakicave etj.).

22. Kushtetuta në nenin 55 parashikon gëzimin në mënyrë të barabartë të së drejtës së çdo shtetasi për kujdes shëndetësor. Si një e drejtë themelore, shteti luan rol kryesor në garantimin e sigurisë së pacientit, bazuar në parimin e mosdiskriminimit.

*Në fushën e formimit të sindikatave*

23. Neni 46 i Kushtetutës parashikon se: Kushdo ka të drejtë të organizohet kolektivisht për çfarëdo qëllimi të ligjshëm.

Liria sindikale mbrohet me ligj (neni 10 dhe 181 i Kodit të Punës).

Të gjithë punëmarrësit pavarësisht nga raca, gjuha, etnia etj. janë të lirë të krijojnë dhe të anëtarësohen në sindikatë të krijuar mbi bazën e ligjit (neni 9 i Kodit të Punës).

Neni 7. Masa ligjore dhe institucionale kundër diskriminimit në fushën e arsimit, kulturës dhe informacionit

*Në fushën e arsimit*

24. Ligji nr. 69/2012, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e



Shqipërisë”. Ligji për sistemin arsimor parauniversitar ka si qëllim kryesor garantimin e së drejtës kushtetuese për arsimim për të gjithë, sipas kuadrit ligjor përkatës, për funksionimin e sistemit arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë (RSH-së). Si të gjitha aktet e tjera normative të këtij lloji, ligji është gjithëpërfshirës. Në këtë kontekst, ligji mbështet edukimin dhe arsimimin e të gjithë fëmijëve pa dallim, e në këtë kuptim mbështet edhe edukimin e fëmijëve romë/egjiptianë, por edhe të shtresave të tjera të diferencuara të shoqërisë. “Sistemi arsimor parauniversitar ka për qëllim formimin e çdo individi, në mënyrë që të përballojë sfidat e së ardhmes, të jetë i përgjegjshëm për familjen, shoqërinë e kombin (neni 3).

25. Ky ligj fokusohet në zhvillimin e trashëgimisë, shumëllojshmërisë sonë kulturore dhe respektin për traditat e popujve të tjerë. “E drejta për arsimim” (neni 5, pika 1) garanton të drejtën për arsimimin e të gjithë shtetasve, pa diskriminim mbi baza racore, gjinie, ngjyre, etnie, gjuhe etj. Konkretisht, garantohet e drejta për arsimimin e shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi, pa u diskriminuar nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike ose fetare, gjendja, ekonomike apo sociale, mosha, vendbanimi, aftësia e kufizuar ose për arsye të tjera që përcaktohen në legjislacionin shqiptar.

26. Në nenin 10 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”:

- Personave, që u përkasin pakicave kombëtare, u krijohen mundësi të mësojnë dhe të mësohen në gjuhën amtare, të mësojnë historinë dhe kulturën e tyre, sipas planeve dhe programeve mësimore.

- Për të mundësuar pjesëmarrje aktive dhe të barabartë në jetën ekonomike, shoqërore, politike e kulturore të Republikës së Shqipërisë, nxënësve të pakicave kombëtare u krijohen kushte për mësimin e gjuhës shqipe dhe njohjen e historisë e të kulturës shqiptare.

- Planet e programet mësimore, si dhe raportet e përdorimit të gjuhës amtare dhe asaj zyrtare në procesin mësimor përcaktohen me akte të veçanta të ministrit.

#### *Në fushën e kulturës*

27. Në lidhje me masat e ndërmarra për mosdiskriminim në fushën e kulturës, si dhe promovimit të kulturës së pakicave, në Ministrinë e Kulturës është krijuar një sektor i veçantë, i cili

merret ndër të tjera dhe me mbrojtjen e promovimin e diversitetit të shprehive kulturore dhe ushtrimin e të drejtave kulturore. Në këtë kuadër është hartuar strategjia “Trego kulturën tënde”<sup>10</sup>, një strategji e cila synon inventarizimin, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë jomateriale dhe shprehive kulturore të komuniteteve, përfshirë këtu të gjitha grupet dhe pakicat kombëtare dhe ato etno-gjuhësore. Kjo strategji po realizohet përmes bashkëpunimit me vetë komunitetet, të cilat kanë rol parësor në evidentimin dhe regjistrimin e elementëve të trashëgimisë jomateriale të tyre, ashtu siç ata paraqiten sot.

28. Në planin financiar, Ministria e Kulturës çdo vit parashikon rritje në buxhetin e saj të alokuar për veprimtaritë kulturore dhe për përfshirjen e publikut në to. Gjithashtu, drejtim tjetër janë fonde nga donatorë të ndryshëm me qëllim mbrojtjen dhe ruajtjen e identitetit kulturor dhe gjallërimin e jetës kulturore në tërësi, si dhe të komuniteteve në veçanti. Politikat transparente të shpërndarjes së këtyre fondeve janë orientuar në mënyrë të tillë që të përfitojnë të gjitha grupet shoqërore të interesuara.

#### *Në fushën e informacionit*

29. Në kuadër të gjithëpërfshirjes dhe mosdiskriminimit në fushën e informacionit, ligji nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në RSH”, parashikon se shërbimi i transmetimit audio: 1. Operohet, zotërohet dhe drejtohet nga komuniteti të cilit i shërbejnë. 2. Ofrohet pa qëllim fitimi, duke reflektuar nevojat kulturore, gjuhësore, demografike, të besimit të komunitetit. 3. Ofron programe me rëndësi të veçantë për komunitetin, duke përfshirë, por pa u kufizuar në çështje të zhvillimit, kujdesin shëndetësor, informacione bazë, edukim të përgjithshëm, çështje të ambientit, reflektim të kulturës lokale etj.

30. Bazuar në qëllimet kryesore të veprimtarisë Radio Televizioni Shqiptar (RTSH), synohet që: programet të pasqyrojnë elementet e ndryshme njerëzore dhe kulturore dhe t’i kushtojnë vëmendje të veçantë elementeve dalluese të kulturës dhe gjuhës shqipe; të sigurojë një gamë të plotë të programeve në gjuhën shqipe, që pasqyrojnë larminë kulturore, argëtojnë, informojnë dhe edukojnë publikun, sigurojnë mbulimin e

<sup>10</sup> Lancuar më 21 maj 2014, në Ditën Botërore të Diversitetit Kulturor.





pasqyrimin të veprimtarive sportive, fetare e kulturore dhe plotësojnë pritshmëritë e publikut në përgjithësi, si dhe të individëve, që i përkasin pakicave shoqërore, duke respektuar në çdo rast dinjitetin njerëzor.

31. Ligji nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, në dispozitat dhe parimet bazë të të cilit përfshihen edhe nene e përcaktime për ndalimin e programeve që përmbajnë ose nxisin diskriminimin racor ose lloje të tjera diskriminimi. Konkretisht, në nenin 32 të ligjit “Rregulla të përgjithshme për ofruesit e shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive”, pika 4, theksohet se ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv nuk transmetojnë programe me përmbajtje që të nxisin urrejtjen mbi baza racore, gjinie, fetare, etnike, kombëtare dhe çdo forme tjetër diskriminimi”. Në këtë ligj përcaktohet se: “Transmetimet audiovizive të të gjitha llojeve respektojnë të drejtën e barazisë dhe mosdiskriminimit për çdo shkak të mbrojtur nga legjislacioni shqiptar”. Gjithashtu, komunikimet me natyrë tregtare në transmetimet audiovizive nuk lejohen “të përfshijnë ose të mbështesin diskriminimin në bazë seksu, race ose origjine etnike, kombësie, moshe, besimi, feje, paaftësie ose orientimi seksual”. Operatorët e shërbimit mediatik audioviziv duhet të jenë të hapur ndaj ideve, opinionëve, tendencave të ndryshme politike, shoqërore, kulturore e fetare. Transmetimet audiovizive duhet të ruajnë e të promovojnë veçanëritë etnike dhe trashëgiminë kulturore, artistike e mjedisore në nivel kombëtar e lokal”. “Transmetimet audiovizive informative nuk duhet të përmbajnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të nënkuptojnë mesazhe diskriminuese për shkaqe, si: gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore ose çdo shkak tjetër”.

## II. INFORMACION MBI ÇËSHTJET DHE REKOMANDIMET E PARAQITURA NGA KOMITETI I EKSPERTËVE PAS SHQYRTIMIT TË RAPORTIT TË SHQIPËRISË

### *Rekomandimi 6. Informacione lidhur me censusin*

32. Ndryshimet në ligjin “Për censusin e përgjithshëm të popullsisë dhe banesave” në vitin

2011<sup>11</sup> përcaktojnë se “census” është mbledhja e informacionit me anë të pyetësorëve dhe përpunimi i të dhënave të tilla, në mënyrë që të sigurojë një numërim të plotë të të gjithë individëve, familjeve e banesave dhe të ndërtesave të shfrytëzuara për qëllime banimi brenda territorit të RSH-së, në një moment të vetëm në kohë, si dhe prodhimi i statistikave në lidhje me karakteristikat demografike, ekonomike dhe sociale të popullsisë së Shqipërisë. Në lidhje me “detyrimin për t’u përgjigjur, ligji parashikon se “të gjithë personat me shtetësi shqiptare apo të huaj, si dhe personat pa shtetësi, me përjashtim të personelit diplomatik të akredituar në Shqipëri, të cilët në momentin e censusit ndodhen brenda territorit të RSH-së, duhet të japin informacionin e kërkuar në pyetësorët e censusit të popullsisë dhe të banesave, sipas parashikimeve të këtij ligji.

33. Ligji mbi censusin përmban një dispozitë të veçantë mbi informimin publik të qëllimit dhe procedurave të censusit, si dhe detyrimet juridike lidhur me të bëhen publike nëpërmjet mediave dhe një fushate të gjerë informimi, të drejtuar nga INSTAT-i. Fushata informuese fillon 8 javë para ditës së censusit dhe përfundon me nxjerrjen e rezultateve paraprake të censusit. Ligji ka përcaktuar shkeljet dhe sanksionet përkatëse me gjobë, të cilat përbëjnë kundërvajtje penale: 1. Refuzimi për të bërë deklaram ose deklarimi i rremë; 2. Mosrespektimi i rregullave të konfidencialitetit, dhe rregullat e tjera të përcaktuara në këtë ligj. Gjithashtu, ligji mbi censusin ka parashikuar edhe të drejtën e ankimit ndaj sanksioneve për kundërvajtjen administrative. Sipas informacioneve të INSTAT-it, si institucioni përgjegjës për vlerësimin e kundërvajtjeve administrative, nuk ka pasur asnjë rast të zbatimit të gjobës për deklarim të rremë të të dhënave, përfshirë edhe të dhënat e përkatësisë etnike.

34. Pyetësori i censusit të popullsisë dhe banesave të vitit 2011, gjatë fazës së përgatitjes së tij iu nënshtrua procesit të konsultimit të grupeve të interesit, ku u kryen një sërë takimesh edhe në lidhje me pyetjet që do të përmbante pyetësori. Këto takime patën si qëllim informimin e publikut mbi procesin dhe rëndësinë e censusit,

<sup>11</sup> Ligji nr. 10 442, datë 7.7.2011, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8669, datë 26.10.2000”, të ndryshuar.



por edhe për të bërë të mundur pasqyrimin e kërkesave të përdoruesve.

35. Në pyetësorin e censusit të vitit 2011 në Shqipëri, ashtu si në shumicën e vendeve të rajonit, u përfshi pyetja mbi përkatësinë etnike, pyetja mbi përkatësinë fetare dhe pyetja mbi gjuhën amtare. Sipas standardeve ndërkombëtare pyetjet mbi karakteristikat etnike dhe kulturore në censusin e popullsisë dhe banesave i referohen të dhënave mbi gjuhën, përkatësinë etnike dhe atë fetare. Pyetjet lidhur me përkatësinë etnike dhe atë fetare kanë qenë pyetje fakultative (jo të detyrueshme) dhe bazohen në deklarin e lirë të personave, si dhe lejonin mundësinë që të intervistuarit të mos përgjigjeshin. Përkatësia etnike është përcaktuar si “një kuptim i përbashkët i origjinës historike dhe territoriale të një grupi etnik ose komuniteti duke përfshirë karakteristika të veçanta që përfshijnë gjuhën, kulturën, fenë, zakonet dhe mënyrën e jetesës. Pyetja mbi përkatësinë etnike krijonte mundësinë për të vetëdeklaruar përkatësinë etnike ose për të zgjedhur alternativën për mospërgjigjen.

36. Në lidhje me pyetjet fakultative nuk u parashikuan modalitete të parakodimit dhe nga procesi i përpunimit të të dhënave rezultuan 430 përgjigje për të dhënat mbi përkatësinë etno-kulturore. Mbledhja e të dhënave nëpërmjet pyetjeve të hapura ishte një proces kompleks dhe kjo përjasje krijoi mundësinë për të intervistuarit për të vetëdeklaruar përkatësinë e tyre etnike. Procedurat e klasifikimit dhe përgatitja e tabelave të të dhënave mbi pyetjet fakultative (siç ishte pyetja e përkatësisë etnike) janë bazuar në standardet ndërkombëtare mbi të dhënat mbi gjuhën, etninë dhe fenë, si dhe rekomandimet e Konferencës së Statisticienëve Evropianë (EUROSTAT) për censuset e popullsisë dhe banesave. Pyetja e gjuhës amtare është përpunuar dhe analizuar pa marrë parasysh përgjigjet në pyetjen e grupit etno-kulturor apo besimit<sup>12</sup>.

37. Në lidhje me kategoritë e të dhënave dhe përdorimin e tyre, ligji parashikon se: 1) Të dhënat e mbledhura nga censusi kategorizohen në: a) identifikuese dhe personale të individëve; b) identifikuese dhe strukturore të ndërtesave, banesave, banesave të jetesës kolektive. 2) Të

dhënat e mbledhura nga censusi do të përdoren vetëm për qëllime statistikore, në përputhje me ligjin “Për statistikat zyrtare”, dhe me standardet e rekomandimet ndërkombëtare. Ky ligj përcakton shprehimisht se të dhënat e mbledhura nga censusi nuk do të përdoren për asnjë listë elektorale ose për përditësimin e asnjë regjistri të gjendjes civile dhe të asnjë regjistri tjetër administrativ. Konfidencialiteti i të dhënave të grumbulluara nga censusi është i mbrojtur nga dispozitat e këtij ligji dhe nga legjislacioni në fuqi. Rezultatet statistikore, të grumbulluara nga censusi, publikohen në nivel kombëtar dhe në nivel vendor, duke siguruar që ato të jenë të paraqitura në një formë, që përjashton identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të individit.

38. Në përmbushje të angazhimeve ndërkombëtare, vetidentifikimi si kriter subjektiv dhe kriteret objektive që lidhen me identitetin e personit do të përbëjnë kriteret bazë për identifikimin e përkatësisë etnike të popullsisë. Në projektligjin për mbrojtjen e të drejtave të pakicave, një vend të rëndësishëm zë e drejta e vetidentifikimit të përkatësisë etnike, në përputhje me nenin 3 të konventës kuadër, si dhe Kushtetutën e RSH-së, duke garantuar të drejtën e çdo personi që i përket një pakice kombëtare për të zgjedhur lirisht për t’u trajtuar ose jo si i tillë, si dhe garantimin e të drejtave që lidhen me këtë zgjedhje, në mënyrë individuale dhe në bashkësi me të tjerët.

*Rekomandimi 7. Rishikimi i kriterëve mbi bazën e të cilave bazohet dallimi ndërmjet pakicave kombëtare dhe pakicave gjuhësore, në konsultim me grupet përkatëse dhe mosdiskriminimi në aspektin e mbrojtjes ose gëzimit të të drejtave*

39. Shqipëria ka pasur dhe vazhdon të ketë një angazhim të përhershëm, për sa i përket përmirësimit të vazhdueshëm të standardeve, lidhur me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, pjesë përbërëse e të cilave janë dhe të drejtat e pakicave. Aktualisht, Shqipëria e bazon procesin e njohjes së pakicave kombëtare (në situatën ligjore ku përkufizimi i pakicës kombëtare mungonte) në traditën historike, si dhe kriteret e përcaktuara nga konventat ndërkombëtare, siç janë kriteret objektive të cilat kanë të bëjnë me ekzistencën e karakteristikave etnike, kulturore, fetare, gjuhësore të veçanta dhe të qëndrueshme, nga pjesa tjetër e popullsisë të këtij grupi, si dhe me shfaqjen e vullnetit për të ruajtur

<sup>12</sup> Në faqen e internetit të INSTAT-it janë publikuar edhe të dhënat mbi pyetjen për gjuhën amtare dhe pyetjen mbi përkatësinë fetare.



kulturën, traditat, fenë, gjuhën e tyre, si dhe kriterin që nënkupton zgjedhjen personale për të qenë pjesë e pakicës.

40. Pakica greke, maqedonase dhe serbe-malazeze janë njohur historikisht si pakica kombëtare, ndërsa romët dhe arumunët janë njohur si pakica etno-gjuhësore. Është e rëndësishme të theksohet se statusi i pakicës kombëtare apo etno-gjuhësore nga pikëpamja ligjore nuk ka pasur ndonjë efekt negativ apo diskriminues lidhur me respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të këtyre pakicave<sup>13</sup>.

41. Duke e konsideruar ruajtjen dhe shprehjen e identitetit kombëtar fetar e kulturor të pakicave, si një element të rëndësishëm të shoqërisë shqiptare, ndër objektivat kryesore në fushën e respektimit të të drejtave të njeriut është përmirësimi i mëtejshëm i mbrojtjes së të drejtave të tyre, në përputhje me standardet evropiane dhe konform angazhimeve që ka marrë Shqipëria në kuadër të organizatave ndërkombëtare, si dhe realizimi në praktikë i të këtyre të drejtave.

42. Përgatitja e projektligjit mbi pakicat është një ndër angazhimet kryesore të qeverisë shqiptare në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga anëtarësimi në Konventën Kuadër të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, dhe në përmbushje të rekomandimeve të organizmave monitorues të Konventës Kuadër. Gjithashtu, në kuadrin e procesit të integritimit evropian dhe konkretisht, mbi përmbushjen e 5 prioritetëve të rekomanduara nga Komisioni Evropian është parashikuar si objektiv “përmirësimi i kuadrit ligjor dhe politikave për mbrojtjen e pakicave pas një procesi konsultimi të gjerë që duhet të marrë parasysh rekomandimet e Komitetit Këshillues të Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës për “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare”, si dhe rezolutës së Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës<sup>14</sup>.

43. Me qëllim përmirësimin e kuadrit ligjor, nënligjor dhe institucional mbi pakicat, qeveria shqiptare ndërmori nismën për hartimin e një ligji specifik mbi pakicat, me qëllim plotësimin e mangësive ligjore dhe qartësimin e politikave ndaj personave që u përkasin pakicave kombëtare, duke eliminuar çdo shkak për trajtim të diferencuar mes kategorive të pakicave kombëtare dhe atyre etno-gjuhësore. Projektligji i konceptuar si një projektligj kuadër adreson një sërë çështjesh që lidhen me përkufizimin, kriteret ligjore të njohjes, shmangien e dallimeve midis pakicave kombëtare dhe atyre etno-gjuhësore, si dhe përmban parashikime ligjore për garantimin dhe ushtrimin e të drejtave, mekanizmat e përfaqësimit etj. Ky projektligj është miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave në muajin prill 2017 dhe bazuar në legjislacionin e brendshëm do të shqyrtohet dhe miratohet nga Kuvendi i RSH-së.

44. Në këtë projektligj përfshihet përkufizimi i pakicave kombëtare duke shmangur ndarjen aktuale në dy kategori të pakicave (pakicat kombëtare dhe etno-gjuhësore). Në kuptim të këtij projektligji, pakicat kombëtare janë: pakica greke, maqedonase, serbe, malazeze, vllahe/arumune, rome si pakica të njohura tradicionalisht, pakica që kanë një vazhdimësi edhe sipas të dhënave të regjistrimeve të popullsisë (censusit). Në kuptim të këtij projektligji parashikohen si pakica kombëtare edhe pakica boshnjake, si dhe pakica egjiptiane, bazuar në dispozitat e Konventës Kuadër (neni 3 vetidentifikimi), kriteret objektive, të dhënat e censusit (regjistrimit të popullsisë), të dhënat e organeve vendore, si dhe kërkesat e paraqitura nga shoqatat që përfaqësojnë grupet e pakicave apo komuniteteve (si ai boshnjak, egjiptian). Gjithashtu, bazuar në dispozitat e Konventës Kuadër, mbi fushën e gjerë të zbatimit, ky ligj parashikon mundësinë e njohjes së pakicave të reja në të ardhmen, bazuar në kriteret ligjore.

*Rekomandimi 8. Ushtrimi i të drejtave të pakicave pa diskriminim*

45. Konventa Kuadër e Këshillit të Evropës “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare”, ratifikuar

<sup>13</sup> Ky qëndrim është paraqitur edhe në 4 raportet mbi zbatimin e Konventës Kuadër “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare”, të paraqitura pranë Këshillit të Evropës (konkretisht, në vitet: 2001, 2007, 2011, 2016): <http://www.coe.int/en/web/minorities/albania>

<sup>14</sup> Opinioni i Komitetit Këshillues të Konventës Kuadër mbi gjendjen e pakicave në Shqipëri (nëntor 2011). Rezoluta e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës Faqe|9112

(shkurt 2014). Këto dokumente gjenden të publikuara krahas gjuhës angleze edhe në gjuhën shqipe, si dhe në gjuhën e pakicave:

<http://www.coe.int/en/web/minorities/albania>



nga Shqipëria, përbën bazën mbi të cilën mbështetet mbrojtja e të drejtave të pakicave dhe zbatimi i politikave për pakicat në Shqipëri. Politika e shtetit shqiptar për mbrojtjen e të drejtave të pakicave bazohet në:

- garantimin ligjor dhe zbatimin në praktikë të së drejtës për një trajtim jodiskriminues të personave që u përkasin pakicave në gëzimin e plotë të të gjitha të drejtave njerëzore, si dhe të drejtave civile e lirive politike, që Kushtetuta dhe legjislacioni u garantojnë të gjithë shtetasve shqiptarë;

- marrjen e masave konkrete për të mbrojtur dhe për të respektuar të drejtat e personave që u përkasin pakicave, si: e drejta për të shprehur lirisht përkatësinë e tyre, për të ruajtur e zhvilluar identitetin e tyre, mësimin e gjuhës amtare, veprimtarinë kulturore, ushtrimin e kultit fetar etj.

46. Kushtetuta dhe legjislacioni i brendshëm garanton mbrojtjen nga diskriminimi për shkak edhe të përkatësisë etnike, ushtrimin e të drejtave dhe lirive të tyre në barazi të plotë para ligjit, të drejtën e tyre për të shprehur lirisht përkatësinë e tyre etnike, kulturore, fetare e gjuhësore, si dhe garanton kushtet për të ruajtur, zhvilluar identitetin e tyre kombëtar, kulturor e fetar dhe të drejtat civile e politike. Personat që u përkasin pakicave kanë të drejtë të mësojnë dhe të mësohen në gjuhën e tyre amtare, të bashkohen në organizata e shoqata për mbrojtjen e interesave dhe të identitetit të tyre, si dhe të përfaqësohen në jetën publike dhe politike, në të gjitha nivelet e pushtetit qendror apo vendor.

47. Në kuadrin e përmbushjes së angazhimeve ndërkombëtare, projektligji për pakicat kombëtare është në përputhje me Kushtetutën, detyrimet që burojnë nga Konventa Kuadër e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, si dhe një sërë aktesh ndërkombëtare, të cilat kanë në themel mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Njëkohësisht në hartimin e tij janë marrë për bazë ligje analoge të disa vendeve të Bashkimit Evropian dhe të rajonit, si dhe janë mbajtur parasysh dhe analizuar elementet e mëposhtme:

- Identifikimin dhe analizimin e modeleve ligjore dhe praktikave të mira, lidhur me rregullimin ligjor, institucional dhe adresimin e çështjeve mbi pakicat në vendet e rajonit dhe Evropës Juglindore.

- Rregullimin ligjor në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe rekomandimet specifike të organizatave ndërkombëtare.

- Rregullimin ligjor mbi zbatimin në praktikë të këtyre të drejtave në përputhje me standardet ndërkombëtare.

- Ekspertizën ndërkombëtare të ofruar nga Këshilli i Evropës dhe Komisioneri i Lartë për Pakicat Kombëtare i OSBE-së.

48. Projektligji për mbrojtjen e pakicave kombëtare rregullon ushtrimin drejtave dhe gëzimin e lirive individuale dhe në komunitet të personave që i përkasin pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me parimet e parashikuara në Kushtetutë dhe Konventën Kuadër të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare. Qëllimi i tij është të sigurojë ushtrimin e të drejtave specifike të njeriut për çdo person që i përket një pakice kombëtare që janë të nevojshme për mbrojtjen dhe nxitjen e identitetit dallues të tyre si një komponent thelbësor i një shoqërie të integruar dhe që garantojnë mosdiskriminimin dhe barazinë e plotë para ligjit. Në ushtrimin e këtyre të drejtave, personat që i përkasin pakicave kombëtare, duhet të respektojnë shtetin ligjor, tërësinë territoriale dhe sovranitetin e Republikës së Shqipërisë.

49. Në projektligj zënë një vend të rëndësishëm në të drejtat dhe liritë e pakicave kombëtare. Dispozitat e tij garantojnë të drejtën e një pakice kombëtare që të zgjedhë lirisht që të trajtohet ose jo si i tillë, duke mos pasur asnjë disavantazh nga kjo zgjedhje apo nga ushtrimi i të drejtave që janë të ndërlidhura me këtë zgjedhje. Pakicat i ushtrojnë të drejtat dhe gëzojnë liritë në mënyrë individuale, si dhe në komunitet me të tjerët në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

50. Në projektligj parashikohet ndalimi i diskriminimit të pakicave kombëtare që sjell si pasojë dallime, përjashtime, kufizime apo preferenca, bazuar në identitetin e tij, etnik, gjuhësor, kulturor e fetar, që ka si qëllim apo pasojë pengimin apo bërjen e pamundur të ushtrimit të të drejtave në të njëjtën mënyrë me të tjerët.

51. Projektligji përmban dispozita që garantojnë: lirinë e organizimit dhe të drejtën e përfaqësimit; të drejtën të zgjedhin dhe të zgjidhen, duke qenë pjesë aktive e jetës politike në vend; ushtrimin e lirisë fetare nga çdo person që i përket pakicave kombëtare. Projektligji fokusohet në sigurimin e kushteve për çdo person që i përket pakicave kombëtare pjesëmarrjen në jetën publike, kulturore, sociale dhe ekonomike të vendit. Kjo pjesëmarrje



garantohet që të jetë e barabartë dhe efektive dhe posaçërisht për çështjet lidhur me ruajtjen, mbrojtjen dhe promovimin e kulturës, traditat dhe identitetin e pakicës të të cilës ata i përkasin. Me qëllim mbështetjen e aktiviteteve dhe projekteve që synojnë ruajtjen dhe promovimin e ushtrimit të së drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare, parashikohet krijimi i fondit për pakicat kombëtare.

52. Një vend të rëndësishëm në projektligj zë rregullimi ligjor lidhur me të drejtën që kanë personat që i përkasin pakicave kombëtare për të ruajtur identitetin e tyre gjuhësor, kulturor, fetar dhe trashëgiminë e tyre kulturore në të gjithë territorin e RSH-së. Gjithashtu parashikohet e drejta e personave që i përkasin pakicave kombëtare për t'u arsimuar në gjuhën e pakicës krahas arsimimit në gjuhën shqipe, për t'u shprehur, për t'u informuar dhe për të shpërndarë informacione në gjuhën e pakicës. Dispozitat e projektligjit parashikojnë krijimin e mundësive për ushtrimin e të drejtës së përdorimit të gjuhës të personave që u përkasin pakicave krahas gjuhës shqipe, konkretisht: emrin dhe mbiemrin e tyre; shenja, mbishkrime dhe informacione të tjera të një natyre personale, të dukshme për publikun në çdo aktivitet të jetës së tyre sociale, ekonomike dhe kulturore. Projektligji parashikon dispozita për të drejtën e informimit (media e shkruar dhe ajo audiovizive).

53. Në hartimin dhe zbatimin e kuadrit ligjor, akteve nënligjore dhe politikave që lidhen me garantimin e të drejtave të pakicave, një vend të rëndësishëm zë procesi i konsultimit me shoqatat që përfaqësojnë pakicat, shoqërinë civile dhe grupet e interesit, bazuar në ligjin për konsultimin publik dhe në funksion të realizimit të një procesi të gjerë dhe transparent të konsultimit.

*Rekomandimi 9. Vëjimi i përpjekjeve për të forcuar kornizën institucionale kombëtare kundër racizmit dhe diskriminimit racial duke ndërthurrur ndarjen e burimeve të mjaftueshme buxhetore dhe njerëzore për të siguruar funksionimin e duhur të tyre*

54. Për të garantuar një mbrojtje sa më efektive nga diskriminimi, ligji për mbrojtjen nga diskriminimi parashikon ngritjen e zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), si një institucion publik, i pavarur në ushtrimin e detyrës së tij dhe i vetmi autoritet përgjegjës, që “siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit

diskriminimin” (neni 21 paragrafi 1). Komisioneri ka buxhetin e vet të pavarur, i cili financohet nga buxheti i shtetit dhe nga donacione të ndryshme.

55. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është institucioni kombëtar i cili është krijuar në bazë të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ushtron funksionet e tij në zbatim të Kushtetutës dhe akteve të tjera ligjore në fuqi<sup>15</sup>. Komisioneri ka kompetenca kryesore: a) të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar; b) të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi; c) të kryejë hetime administrative dhe të vendosë sanksione administrative sipas përcaktimit të këtij ligji; d) të nxisë parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për këto çështje; e) t'u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin; g) t'i drejtohet drejtpërdrejt opinionit publik për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin; gj) me kërkesën e gjykatës që shqyrton çështjen, të parashtrijë mendim me shkrim për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin; etj.

56. Në lidhje me ndërgjegjësimin e njerëzve mbi masat ligjore dhe dëmshpërbljeve, Komisioneri gjatë viteve të veprimtarisë ka realizuar ndërgjegjësim të gjerë lidhur me ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe mjetet ligjore për t'u mbrojtur në rast diskriminimi. Numri i ankesave për shkaqe si diskriminimi racial, të paraqitura në KMD, ka ardhur duke u rritur vit pas viti dhe ky fakt dëshmon për ndërgjegjësimin e komunitetit për LMD-në.

Konkretisht janë paraqitur këto ankesa:

Për vitin 2010, nuk ka asnjë ankesë për diskriminim për shkak të racës.

Për vitin 2011 janë paraqitur 2 ankesa për diskriminim për shkak të racës.

Për vitin 2012 janë trajtuar 36 çështje për diskriminim për shkak të racës, nga të cilat në 6 raste çështjet kanë filluar kryesisht nga KMD-ja

<sup>15</sup> Zgjidhet nga Kuvendi i RSH-së me një mandat 5-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Komisioneri raporton të paktën një herë në vit në Kuvendin e Shqipërisë.



(hetime *ex officio*). Ankesat për diskriminim kanë qenë në fushën e punësimit, strehimit dhe arsimit.

Për vitin 2013 janë trajtuar 149 çështje për diskriminim për shkak të racës, nga të cilat në 12 raste çështjet kanë filluar kryesisht nga KMD-ja (hetime *ex officio*). Ankesat për diskriminim kanë qenë në fushën e punësimit, strehimit, arsimit dhe në atë të shërbimeve.

Për vitin 2014 janë trajtuar 164 çështje për diskriminim për shkak të racës, nga të cilat në 4 raste çështjet kanë filluar kryesisht nga KMD-ja (hetime *ex officio*). Problematikat e parashtruara në këto ankesa kanë të bëjnë me pretendimet për: - mospërfitim në mënyrë të padrejtë të trajtimit me ndihmë ekonomike.

57. Gjatë veprimtarisë së tij Komisioneri ka adresuar rekomandime legjislative. KMD-ja ka dhënë rekomandime legjislative, mbi: Kodin e Punës<sup>16</sup>; Kodin Penal; Kodin e Procedurave Administrative<sup>17</sup>; Kodin e Procedurës Civile; ligjin “Për regjistrimin e popullsisë”, ligjin nr. 69/2012, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”; Rekomandimet për ndryshime në Kodin e Transmetimit, duke rekomanduar që transmetimet audiovizive të të gjitha llojeve, të respektojnë parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit për çdo shkak të parashikuar nga legjislacioni shqiptar. Këto propozime në shumicën e rasteve janë marrë parasysh nga institucionet përkatëse, si dhe kanë synuar përqasjen e këtyre ligjeve në përputhje me ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi, me synim një mbrojtje gjithëpërfshirëse të individëve pa u diskriminuar.

58. Raca vazhdon të mbetet shkaku kryesor për të cilin pretendohet diskriminim. Afërsisht 50% e totalit të ankesave të paraqitura pranë KMD-së për vitin 2015 e zënë ato për shkak të racës. Gjatë këtij viti janë trajtuar 88 ankesa dhe 7 çështje të nisura kryesisht me iniciativë të Komisionerit me pretendim diskriminim për shkak të racës. Problematikat e parashtruara nga ankuesit e

komunitetit rom lidhen me: 1. Mospërfitim dhe trajtim i padrejtë për ndihmën ekonomike; 2. Trajtim i pabarabartë në fushën e punësimit, si në sektorin shtetëror, ashtu dhe në atë privat; 3. Mosrespektimi i së drejtës së tyre për strehim dhe mosprishja e banesave të tyre që janë në proces legalizimi.

59. Gjatë vitit 2015 ka përfunduar shqyrtimi i çështjeve për 62 ankesa të bëra nga subjektet dhe 5 çështje të nisura kryesisht nga Komisioneri. KMD-ja në disa raste ka ofruar asistencë për komunitetin rom dhe egjiptian në plotësimin e dokumentacionit për përfitimin e ndihmës ekonomike, për regjistrimin e fëmijëve të tyre në shkollë, regjistrimin në gjendjen civile, përfitimin nga banesat sociale, dhe përfitimin nga tarifatat studentore etj. Vihet re që vazhdon të jetë i pranishëm diskriminimi i strukturuar që nuk i referohet një individi, por të gjithë grupit. Nga analiza e bërë mbi rastet e trajtuara evidentohet se anëtarët e komunitetit rom dhe egjiptian nuk janë të mirinformuar për të drejtat dhe shërbimet që përfitojnë apo rrugët për të siguruar këto shërbime.

60. Për vitin 2014 janë trajtuar 160 ankesa dhe 4 çështje të nisura, kryesisht, me iniciativë të komisionerit, me pretendim diskriminim për shkak të racës. Ato zënë 12% të të gjitha ankesave të bëra pranë KMD-së. Problematikat e parashtruara në këto ankesa të bëra nga individë të komunitetit rom dhe egjiptian lidhen me:

- Mospërfitimin dhe trajtimin e padrejtë për përfitimin e ndihmës ekonomike, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të këtij ligji;

- Caktimin jo korrekt të masës së përfitimit të ndihmës ekonomike apo ndërprerjes së ndihmës ekonomike;

- Trajtimin e pabarabartë në fushën e punësimit, si në sektorin shtetëror ashtu dhe në atë privat;

- Përdorim e gjuhës fyese dhe të nënvlerësimit të ankesave nga ana forcave të ruajtjes së rendit;

- Respektimin e së drejtës për strehim dhe mosprishjen e banesave të tyre që janë në proces legalizimi.

61. Gjatë vitit 2014 ka përfunduar shqyrtimi për 108 çështje<sup>18</sup>. Në pjesën më të madhe të rasteve, ankesat me shkak racën, nuk janë hetuar nga

<sup>16</sup> Ky institucion ka propozuar të shtohen shkaqet e diskriminimit në përputhje me ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. Të shtohen edhe format e tjera të diskriminimit, si: “Udhëzimi për të diskriminuar”, “Shqetësimi”, “Viktimizimi”, “Diskriminimi për shkak të shoqërimit”, si dhe “Mohimi i përshtatjes së arsyeshme”.

<sup>17</sup> Shtimi i shkaqeve të diskriminimit dhe përmbyjsja e barrës së provës në rastet e diskriminimit.

<sup>18</sup> 104 ankesa individuale dhe 4 *ex-officio*.



Komisioneri, pasi nuk plotësojnë kriteret që parashikon ligji 10221/2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. Në përfundim të shqyrtimit dhe hetimit administrativ, KMD-ja ka dhënë përkatësisht këto vendime:

- 6 raste, konstatim diskriminimi;
- 83 raste, është konstatuar mosdiskriminim;
- 4 raste, subjekti ankues ka tërhequr ankesën;
- 12 raste, çështjet nuk janë pranuar për mospërmbushje të kërkesave ligjore;
- 1 rast, është dhënë vendim me gjobë;
- 2 raste, është pushuar shqyrtimi i ankesës për shkak të pamundësisë.

62. KMD-ja ka ofruar asistencë për komunitetin rom dhe egjiptian në plotësimin e dokumentacionit për përfitimin e ndihmës ekonomike, për regjistrimin e fëmijëve të tyre në shkollë, regjistrimin në gjendjen civile, përfitimin nga banesat sociale dhe përfitimin nga tarifatat studentore etj.

63. Lidhur me Avokatin e Popullit, institucioni i Avokatit të Popullit ushtron detyrat e tij sipas ligjit organik “Për Avokatin e Popullit”<sup>19</sup>. Bazuar në këtë ligj (neni 2) përcaktohet se: “Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individëve nga veprimet e paligjshme ose mosveprimet e organeve të parregullta të administratës publike, si dhe të tretëve që veprojnë për llogari të saj”. Kompetenca speciale e përcaktuar në ligj për Avokatin e Popullit, përcakton në mënyrë efektive mbrojtjen e të drejtave të njeriut, liritë dhe interesat e ligjshme të individit. Në këtë marzh të gjerë përcaktimi, në logjikën e ligjit organik përfshihet natyrshëm edhe e drejta për mbrojtjen nga diskriminimi, e cila rrjedh nga parimi kushtetues i barazisë së shtetasve para ligjit.

64. Mbi një interpretim të ngushtë të dispozitave ligjore mund të thuhet se pavarësisht kompetencës më të gjerë që ka Avokati i Popullit në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përcaktimi specifikisht i kompetencës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për sigurimin e mbrojtjes efektive nga diskriminimi për çdo

individ, bën që kjo kompetencë të jetë ekskluzivisht e Komisionerit dhe jo e Avokatit të Popullit.

65. Në një interpretim të gjerë të dispozitave ligjore mund të thuhet se përderisa ligji organik i Avokatit të Popullit përfshin si kompetencë të përgjithshme edhe të drejtën për mbrojtje nga diskriminimi dhe barazinë para ligjit, atëherë nuk ka pengesë ligjore që ky i fundit të trajtojë edhe këto çështje, ku si bazë ngrihen pretendimet për diskriminim. Pra, efektivisht ekziston një ndarje e punës ndërmjet dy institucioneve të Avokatit të Popullit dhe atij të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Kjo ndarje nuk është në vetvete një çështje e mirëpërcaktuar në ligj se sa një çështje e praktikës së mirë të punës, të vendosur ndërmjet dy institucioneve.

*Rekomandimi 9. Përfaqësimi i pakicave kombëtare në Komitetin Shtetëror të Minoriteteve*

66. Komiteti Shtetëror për Minoritetet (KSHM) është krijuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 127, datë 11.3.2004, “Për krijimin e Komitetit Shtetëror për Minoritetet”, dhe ka një status konsultativ për hartimin dhe zbatimin e politikave kombëtare për pakicat. Ai përbëhet nga përfaqësues të zgjedhur të pakicave /shoqatave të pakicave. Komiteti Shtetëror i Minoriteteve ka si objektiv nxitjen e pjesëmarrjes së personave, që u përkasin pakicave, në jetën publike, si dhe për të sugjeruar masa për ushtrimin dhe mbrojtjen e të drejtave e të lirive të tyre. Komiteti Shtetëror i Minoriteteve është institucion qendror, me personalitet juridik, në varësi të Kryeministrit. Komiteti Shtetëror i Minoriteteve bashkëpunon me organet e qeverisjes, qendrore dhe vendore, dhe me organizata e shoqata të ligjshme, që kryejnë veprimtari për ushtrimin e të drejtave dhe të lirive të personave, që u përkasin pakicave. Komiteti Shtetëror i Minoriteteve kryesohet nga kryetari (përfaqësues i pakicës greke) dhe nënkryetari (aktualisht përfaqësues i pakicës arumune/vllehe) dhe ka në përbërje pesë anëtarë (nga një përfaqësues të pakicës greke, pakicës maqedonase, pakicës serbe-malazeze, pakicës rome dhe pakicës arumune/vllehe).

67. Ndër rekomandimet e mekanizmave monitorues të Këshillit të Evropës dhe rekomandimet e Komisionit Evropian është edhe përmirësimi i kuadri institucional për

<sup>19</sup> Ligji nr. 8485, datë 4.2.1999, plotësuar me ligjin nr. 8600, datë 10.4.2000, ndryshuar me ligjin nr. 9398, datë 12.5.2005.



trajtimin e çështjeve të pakicave dhe për strukturimin e dialogut me përfaqësuesit e tyre. Projektligji për mbrojtjen e pakicave kombëtare i kushton një vend të veçantë mekanizmit të përfaqësimit të pakicave. Konkretisht parashikohen dispozita mbi krijimin dhe funksionimin e Komitetit për Pakicat Kombëtare me qëllim sigurimin e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave dhe interesave të pakicave kombëtare sipas parashikimeve të këtij ligji dhe legjisllacionit përkatës në fuqi. Ky projektligj parashikon kompetencat e Komitetit për pakicat Kombëtare, që lidhen kryesisht me dhënien e rekomandimeve dhe opinionëve në lidhje me hartimin e legjisllacionit, politikave dhe programeve që kanë të bëjnë me të drejtat e pakicave kombëtare, bashkëpunimin me institucionet, me qëllim zbatimin e këtij ligji. Projektligji parashikon përbërjen, procesin e përzgjedhjes dhe strukturën e Komitetit, si dhe mënyrën e funksionimit të tij. Në kuptim të këtij projektligji, Komiteti i Pakicave Kombëtare përbëhet nga përfaqësuesit e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë të evidentuara në këtë projektligj, konkretisht: pakicat kombëtare si pakica greke, maqedonase, serbe, malazeze, vllahë/arumune, rome, boshnjake, egjiptiane., duke garantuar në këtë mënyrë edhe përfshirjen e grupeve të reja të pakicave, si pakica boshnjake dhe pakica egjiptiane, bazuar në kriteret objektive dhe kriterin subjektiv (vetidentifikimi).

*Rekomandimi 10. Parimi i vetidentifikimit; procesi i konsultimit të projektligjit*

68. Vetidentifikimi përbën një ndër elementet kryesore të të drejtave të pakicave, në përputhje me konventat ndërkombëtare (neni 3 i Konventës Kuadër). Kjo nënkupton të drejtën e çdo individi për të vetëdeklaruar nëse i përket ose jo një pakice. Siç është evidentuar edhe më sipër<sup>20</sup>. Por, zgjedhja subjektive e individit është e lidhur edhe me kriteret objektive që lidhen me identitetin e një pakice. Projektligji mbi pakicat garanton të drejtën e një pakice kombëtare që të zgjedhë lirisht që të trajtohet ose jo si i tillë, duke mos pasur asnjë disavantazh nga kjo zgjedhje apo nga ushtrimi i të drejtave që janë të ndërlidhura me këtë zgjedhje. Pakicat i ushtrojnë të drejtat dhe gëzojnë liritë në mënyrë individuale, si dhe në komunitet me të tjerët.

69. Ky projektligj u njeh personave që u përkasin pakicave, të drejtën e deklarimit të përkatësisë së tyre bazuar në të drejtën e vetidentifikimit, në regjistrimet periodike të popullsisë dhe rasteve të parashikuara në këtë projektligj. Ky nen u garanton pakicave që, në një regjistrim kombëtar të popullsisë, askush nuk do të detyrohet të zbulojë asnjë lloj të dhëne që lidhet me përkatësinë e tyre në një pakicë kombëtare. Projektligji parashikon mënyrën e mbledhjes së të dhënave në lidhje me identifikimin e personave që u përkasin pakicave kombëtare bazuar në të drejtën e vetidentifikimit të këtyre personave dhe të dhënat që ato paraqesin për të provuar këtë përkatësi.

70. Në kuadrin e përmbushjes së 5 prioriteteve të rekomanduara nga Komisioni Evropian në udhërrëfyesin mbi zbatimin e këtyre prioriteteve<sup>21</sup>, lidhur me mbrojtjen e pakicave si pjesë e prioritetit 5, “Të drejtat e njeriut” është përfshirë si objektivi: “Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe i politikave për respektimin dhe mbrojtjen e pakicave. Në këtë drejtim, të qartësohet dhe të nxitet zbatimi i kuadrit ligjor ekzistues, pas një procesi konsultimi të gjerë që duhet të marrë parasysh rekomandimet e Komitetit Këshillues të Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare”. Për realizimin e angazhimeve mbi pakicat, u ngrit grupi i punës, “Për vlerësimin e kuadrit ligjor dhe të politikave për pakicat” (urdhri nr. 117, datë 10.3.2014 i Kryeministrit), me përfaqësues të institucioneve qendrore, Komitetit Shtetëror të Minoriteteve, Avokatit të Popullit, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi etj. Gjatë periudhës 2014–2015, nën drejtuesin dhe koordinimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, u zhvillua procesi i gjerë i konsultimit, me qëllim: 1. Vlerësimin e kuadrit ligjor aktual dhe politikave për mbrojtjen e pakicave; 2. Evidentimin e çështjeve dhe të problematikave mbi respektimin e të drejtave të pakicave; 3. Paraqitjen e propozimeve të nevojshme, mbi përmirësimin e kuadrit ligjor dhe politikave për pakicat.

71. Në vijim, gjatë vitit 2016 është ngritur grupi ndërinstitucional i punës me urdhrin e Kryeministrit nr. 121, datë 27.7.2016, “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e

<sup>21</sup> VKM-ja nr. 330, datë 28.5.2014, “Për miratimin e udhërrëfyesit për 5 prioritetet e rekomanduara nga Komisioni Evropian 2013”.

<sup>20</sup> Paragrafi 42 i raportit.





projektligj, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në SH”<sup>22</sup>. Në kuadrin e zhvillimit të një procesi të gjerë të konsultimit për pakicat janë zhvilluar takime periodike të grupit ndërinstitucional të punës me përfaqësues të institucioneve qendrore dhe të pavarura, si dhe të Komitetit Shtetëror të Minoriteteve.

72. Në kuadër të procesit të konsultimit, gjatë vitit 2016, janë zhvilluar dy tryeza të rrumbullakëta, konkretisht, një tryezë e veçantë me ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, përfaqësues të shoqatave të pakicave, shoqërisë civile, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, me qëllim shkëmbimin e mendimeve dhe evidentimin e problematikave dhe çështjeve mbi pakicat, me qëllim adresimin e tyre në projektligj. Në muajin tetor 2016 u zhvillua konferenca konsultuese me përfaqësues të institucioneve qendrore dhe të pavarura, përfaqësues të organizmave ndërkombëtare, trupit diplomatik, ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, akademikë, shoqatave të pakicave, shoqërisë civile.

73. Projektligji mbi pakicat i është nënshtruar procesit të njoftimit dhe konsultimit publik në përputhje me ligjin nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, me qëllim gjithëpërfshirjen e aktorëve të interesuar me marrjen e sa më shumë komenteve e rekomandimeve të vlefshme. Në përfundim të procesit të konsultimit konstatohet se janë paraqitur komente nga një sërë shoqatash përkatësisht të pakicave greke, maqedonase, serbe, malazeze, rome, të komunitetit egjiptian dhe atij boshnjak, si dhe nga shoqëria civile, ekspertë dhe akademikë. Gjatë procesit të hartimit të këtij projektligji është konsultuar dhe mbajtur parasysh edhe ekspertiza ndërkombëtare e Këshillit të Evropës dhe Komisionerit të Lartë për Pakicat Kombëtare të OSBE-së.

*Rekomandimi 12. Adresimi i situatës së personave që i përkasin pakicës arumune*

74. Siç është evidentuar edhe më sipër, Kushtetuta dhe legjislacioni i brendshëm garanton mbrojtjen nga diskriminimi për shkak edhe të përkatësisë etnike, ushtrimin e të drejtave dhe lirive të tyre në barazi të plotë para ligjit, të drejtën e tyre për të shprehur lirisht përkatësinë e tyre etnike, kulturore, fetare e gjuhësore, si dhe garanton kushtet për të ruajtur, për të zhvilluar identitetin e tyre kombëtar, kulturor e fetar dhe të drejtat civile e

politike për të gjitha pakicat përfshirë edhe pakicën arumune. Miratimi i projektligjit për pakicat do të garantojë një mbrojtje efektive dhe pa diskriminim të të gjitha pakicave<sup>22</sup>.

*Rekomandimi 11. Informacione lidhur me masat e ndërmarra për përmirësimin e kushteve të romëve dhe egjiptianëve në fushat e arsimit, strehimit, punësimit, shëndetësisë dhe shërbimeve sociale*

75. Në kuadër të zbatimit dhe monitorimit të masave kundër diskriminimit të komuniteteve rome dhe egjiptiane, përveç raporteve të progresit të hartuara nga organizatat e shoqërisë civile mbi zbatueshmërinë e kuadrit strategjik për romët, si p.sh. “Raporti i monitorimit të shoqërisë civile për implementimin e strategjisë kombëtare të integritimit të komunitetit rom” dhe të “Planit të veprimit të dekadës në vitin 2012 dhe 2013 në Shqipëri”, qeveria e Shqipërisë ka përgatitur një raport progresi në vitin 2010, si dhe një tjetër analizë në vitin 2014. Analiza e fundit e vitit 2014, mbi progresin e zbatimit të “Strategjisë kombëtare për integrimin e komunitetit rom në Shqipëri”, si dhe planit kombëtar të veprimit për dekadën e përfshirjes së romëve, 2010–2015, u realizua në kuadër të përpjekjeve për të monitoruar zbatimin, për të identifikuar fushat dhe aspektet për ndërhyrje të mëtejshme, si dhe për të përgatitur “Planin kombëtar për integrimin e romëve dhe egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë”, 2016–2020.

76. “Plani kombëtar i veprimit për integrimin e romëve dhe egjiptianëve” është një dokument i hartuar nga qeveria shqiptare dhe nën koordinimin e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR). Ky plan është një angazhim i ri, me kohështrirje 2016–2020, i cili targeton dy komunitetet përkatëse, paraqet një përshkallëzim të masave të zbatuara dhe në zbatim dhe parashikon, gjithashtu, nisjen e aktiviteteve të reja për nxitjen e integritimit të romëve dhe egjiptianëve me fondet e parashikuara nga buxheti i shtetit, por duke identifikuar edhe hendekun financiar për periudhën 2016–2020 dhe mundësinë e financimit nëpërmjet koordinimit me ndihmën e huaj. Plani i veprimit është hartuar në konsultim të ngushtë me ministritë përgjegjëse të linjës, përfaqësues nga komuniteti rom dhe egjiptian, si dhe aktorë të tjerë. Pas marrjes

<sup>22</sup> Referim i informacionit të paraqitur në paragrafët 42, 46-50 më sipër.



së statusit të vendit kandidat në BE në vitin 2014, qeveria shqiptare intensifikoi reformat e nevojshme për aderimin e saj, përfshirë edhe nxitjen e aksesit të barabartë në shërbime dhe të të drejtave të barabarta për të gjithë shtetasit. Në këtë kuadër, vëmendje e veçantë u kushtohet masave që mund të shembin barrierat me të cilat përballen romët dhe egjiptianët sa i përket aksesit në shërbime, përmirësimit të kushteve të tyre të jetesës nëpërmjet integritit dhe nxitjes së dialogut ndërkulturor.

77. Parimet që udhëheqin “Planin kombëtar të veprimit për integrimin e romëve dhe egjiptianëve” janë:

- Nxitja e përfshirjes sociale – Aktivitetet e planit të veprimit synojnë të nxisin përfshirjen e romëve dhe egjiptianëve në shoqëri e jo të krijojnë sisteme paralele për t’u përdorur nga këto komunitete.

- Përdorimi i një qasjeje të targetuar/synuar për trajtimin e çështjeve specifike të përjashtimit – Planit i veprimit propozon, gjithashtu, masa të targetuara për përgjigjen ndaj 4 situatave të emergjencës që nuk mund të trajtohen përmes burimeve të përgjithshme. Ndërhyrjet e targetuara nuk do të krijojnë diskriminim (p.sh., përmes strehimit apo klasave të ndara për romët dhe egjiptianët), por synojnë të lidhin romët dhe egjiptianët me sistemin e përgjithshëm dhe të përmirësojnë aksesin e tyre në shërbimet publike ekzistuese.

- Respektimi i dallimeve – Planit i veprimit respekton dallimet mes komunitetit rom dhe atij egjiptian, si dhe brenda vetë këtyre komuniteteve. Planit i veprimit trajton anëtarët vulnerabël të këtyre komuniteteve, duke njohur faktin që disa romë dhe egjiptianë janë tashmë të integruar në shoqëri.

- Vënia e theksit mbi angazhimin e romëve dhe egjiptianëve – Planit i veprimit përfshin mekanizmat për angazhimin e romëve dhe egjiptianëve në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave publike.

- Nxitja e bashkëpunimit midis aktorëve të ndryshëm – Krijimi dhe zbatimi i planit të veprimit bazohet në bashkëpunimin midis qeverisjes qendrore, rajonale dhe vendore, shoqërisë civile, komunitetit ndërkombëtar dhe veçanërisht vetë komuniteteve.

- Promovimi i lidhjeve ndërsektoriale – Planit i veprimit trajton nevojat në një sërë fushash kyçe

përfshirë: arsimin dhe promovimin e dialogut ndërkulturor, shëndetësinë, strehimin dhe integrimin urban, punësimin dhe arsimin e aftësimin profesional, mbrojtjen sociale, regjistrimin civil dhe aksesin në sistemin e drejtësisë, me synim nxitjen e integritit në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.

- Matja e progresit – Planit i veprimit është i pajisur me tregues për matjen e progresit të zbatimit dhe treguesit fillestarë (nga ku do të nisë puna) kur është e mundur.

- Ndërgjegjësimi mbi dimensionin gjinor – Planit i veprimit pranon faktin se gratë romë dhe egjiptiane kanë më tepër gjasa të vuajnë përjashtimin dhe diskriminimin gjinor. Dokumenti bën, gjithashtu, thirrje për mbledhjen e të dhënave të disagreguara sipas gjinisë për çdo tregues përkatës.

- Buxhetimi për zbatimin – ministritë e linjës kanë identifikuar një buxhet për zbatimin e çdo aktiviteti. Në rastet kur financimi publik është i pamjaftueshëm, ministritë kanë identifikuar edhe hendeqet e financimit ku mund të kërkohet ndihmë nga donatorë.

78. Matrica e planit të veprimit përshkruan qëllimet, objektivat dhe aktivitetet, afatet e zbatimit, autoritetet përgjegjëse për zbatim dhe kontroll, vlerat e treguesve dhe të pikës së nisjes, burimet e informimit, dokumentet strategjike përkatëse, si dhe fondet e nevojshme për zbatimin e planit të veprimit. Sektorët prioritarë, janë specifikisht: 1. Regjistrimi civil dhe aksesin në drejtësi; 2. Arsimi dhe promovimi i dialogut ndërkulturor; 3. Punësimi, arsimi e formimi profesional; 4. Kujdesi shëndetësor; 5. Strehimi dhe integrimi urban; 6. Mbrojtja sociale.

79. Në vazhdim të punës dhe përpjekjeve të MMSR-së për krijimin e një mekanizmi efektiv të monitorimit dhe vlerësimit të progresit në nivel kombëtar të planit kombëtar të veprimit, si dhe për bashkëveprimin ndërmjet ministrive të linjës dhe institucioneve/zyrave qeveritare u aktivizua sistemi elektronik *online* ROMALB, si një sistem në të cilin do të hidhen dhe përditësohen të dhëna për treguesit e Planit të veprimit 2016–2020 dhe që do të kontribuojnë, në: i) lehtësimin e veprimtarisë së Drejtorisë së Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore pranë MMSR-së në mbledhjen e të dhënave dhe harmonizimin e statistikave në kohë reale për nivele të ndryshme ndërhyrjesh në



komunitetet rome dhe egjiptiane; ii) monitorimin dhe analizën e të dhënave në nivel kombëtar të indikatorëve të planit të veprimit; iii) përmirësimin e cilësisë së raporteve të gjeneruara nga stafi i DPSBGJ-së dhe; iv) kompjuterizimin e mbledhjes së të dhënave për romët dhe egjiptianët, me qëllim monitorimin e ndërhyrjeve dhe vlerësimin e situatës për përmirësimin e cilësisë së jetesës së tyre. Koordinimi dhe harmonizimi i këtij sistemi me sisteme të ngjashme elektronike do të ndiqet qysh në hapat e parë të punës në mënyrë që të shmangen mbivendosjet dhe të rritet efektshmëria.

80. MMSR-ja ka marrë masat për trajnimin dhe ofrimin e asistencës teknike të vazhdueshme të përdoruesve të sistemit elektronik ROMALB, për regjistrimin e të dhënave të treguesve të monitorimit, përditësimin e tyre, si dhe për administrimin e përshtatshëm të këtij sistemi. Në funksion të përdorimit me efektivitet të sistemit ROMALB, DPSBGJ-ja, në cilësinë e koordinorit të zbatimit dhe raportimit të këtij plani veprimi, po bashkëpunon dhe bashkërendon punën, përveçse me të gjitha ministrinë e linjës, edhe me institucione të tjera të pavarura, si dhe do të propozojë masa për eficiencën e sistemit elektronik dhe përmirësimin e tij në të ardhmen.

81. Ligji nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton mënyrën e sigurimit për çdo individ apo kategori njerëzish për të përfituar shërbim shëndetësor. Të gjithë personat që u përkasin pakicave janë shtetas shqiptar dhe shërbimin shëndetësor e kanë të garantuar në bazë të këtij ligji. Në nenin 5 të këtij ligji, “Persona të siguruar”, pika 2/e, për disa kategori personash që përcaktohen me ligje të veçanta, përfshihen grupe apo kategori të cilëve kontributin e sigurimit shëndetësor ua mbulon shteti.

82. Institucionet shëndetësore të nivelit parësor (qendrat shëndetësore) dhe të nivelit dytësor (shërbimi i specializuar ambulator dhe ai spitalor), funksionojnë në bazë të kontraktimit të tyre me Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor. Qendrat shëndetësore ofrojnë shërbime sipas paketës bazë të shërbimeve në kujdesin parësor.

83. Ministria e Shëndetësisë, nëpërmjet Institutit të Shëndetit Publik, ka zhvilluar aktivitete promovionale me popullatat rome, lidhur me

kujdesin për fëmijën, ushqyerjen, vaksinimin dhe planifikimin familjar. Fillimisht është bërë identifikimi dhe mbulimi me shërbime të imunizimit për grupet e marginalizuara/në rrezik në çdo rreth (sidomos popullata rome në zonat rurale). Vaksinimi është një shërbim i ofruar falas për të gjithë popullatën, përfshirë edhe fëmijët romë dhe egjiptianë. Instituti i Shëndetit Publik bën depistim të zonave ku jetojnë familjet rome dhe egjiptiane për të identifikuar fëmijët e pavaksinuar. Të gjithë fëmijët romë dhe egjiptianë vaksinohen falas edhe kur ato nuk kanë dokumente. Aktivitete edukuese dhe promovuese janë zhvilluar në qendrat shëndetësore, duke trajtuar kryesisht çështjet e shëndetit riprodhues, shëndeti i nënës dhe fëmijës, masat e duhura për mbrojtjen nga HIV-i/AIDS-i në këto komunitete, programe ndërgjegjësuese për higjienën personale dhe zonave të banimit.

*Rekomandimi 13. Pjesëmarrja efektive në jetën publike dhe politike të pakicave*

84. Komiteti Shtetëror për Minoritetet (KSHM) është krijuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 127, datë 11.3.2004, “Për krijimin e Komitetit Shtetëror për Minoritetet”, dhe ka një status konsultativ për hartimin dhe zbatimin e politikave kombëtare për pakicat. Ai përbëhet nga përfaqësues të zgjedhur të pakicave/shoqatave të pakicave. KSHM-ja funksionon si organi kolegjal konsultativ i institucioneve shtetërore dhe është një strukturë e rëndësishme për përcimin e zërit të grupeve të interesit (pakicave) pranë qeverisë dhe vendimmarrësve, duke u dhënë konsulencë për çështje të pakicave. Megjithatë, që prej formimit të tij, KSHM-ja ka evoluar pak dhe nuk ka arritur të paraqesë dinamikën e kërkuar prej shoqatave të pakicave që ai përfaqëson. Komiteti Shtetëror i Minoriteteve ka qenë i përfaqësuar dhe ka dhënë kontribut në grupin ndërinstitucional të punës për vlerësimin e kuadrit ligjor dhe politikave për minoritetet.

Pjesëmarrja politike. Procesi zgjedhor dhe përfaqësimi

85. Kushtetuta në nenin 45 i garanton çdo shtetasi të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet. E drejtë kjo që u garantohet në mënyrë të barabartë të gjithë shtetasve shqiptarë ku përfshihen edhe shtetasit shqiptarë që u përkasin pakicave kombëtare. Në këtë kuadër, ata janë të lirë të bashkohen në parti politike, si dhe të krijojnë vetë



parti politike, në ushtrim të të drejtave dhe lirive të njohura nga Kushtetuta. Mbështetur në këtë dispozitë, pakicat kombëtare kanë të drejtë të zgjedhin dhe të zgjidhen, duke qenë pjesë aktive e jetës politike në vend. Çdo person është i lirë të themelojë një parti politike, si dhe të jetë anëtar në një parti të caktuar politike, në rast se ka të njëjtat ide, bindje apo interesa të ligjshme, gjë e cila gjen mbështetje edhe në nenin 1, të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000, “Për partitë politike”, i ndryshuar, i cili edhe pse nuk parashikon në mënyrë specifike dispozita për apo lidhur me pakicat kombëtare, parashikon përkufizimin e partive politike, të cilat janë: “Bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, të bindjeve e të pikëpamjeve ose të interesave të përbashkëta politike, të cilat synojnë të ndikojnë në jetën e vendit nëpërmjet pjesëmarrjes në zgjedhjet dhe përfaqësimit të popullit në organet e zgjedhura të pushtetit”. Ky ligj nuk pengon krijimin e partive nga pakicat kombëtare, mjafton të përmbushen kushtet që parashikon ligji për krijimin e tyre.

86. Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (neni 7/4) garanton se, çdo shtetas shqiptar, që ka mbushur moshën 18 vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, pa dallim race, etnie, gjinie, gjuhe, bindjeje politike, besimi, aftësie fizike ose gjendjeje ekonomike ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet, në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë Kod (neni 3/3 i Kodit Zgjedhor, i ndryshuar). Shtetasit shqiptarë që plotësojnë kushtet e parashikuara në këtë Kod (neni 63), pavarësisht nëse bëjnë pjesë në një pakicë kombëtare të caktuar ose jo kanë të drejtë të zgjedhin dhe të zgjidhen. Gjithashtu, në dokumentet e kandidimit (neni 72), kandidatët nuk deklarojnë përkatësinë etnike dhe në këto kushte nuk ka statistika se sa kandidatë u përkasin minoriteteve dhe sa nga këta janë të zgjedhur. Neni 165 i Kodit Zgjedhor përcakton sistemin e zgjedhjeve vendore, sipas të cilit kryetarët e bashkive dhe këshillat e bashkive zgjidhen me votim të drejtpërdrejtë nga zgjedhësit me vendbanim në territorin e bashkisë ose të komunës. Anëtarët e tyre zgjidhen në bazë të listave shumëmemërore të paraqitura nga partitë politike, koalicionet ose të kandidaturave të propozuara nga zgjedhësit. Partitë politike të regjistruara si koalicion në KQZ paraqesin vetëm një kandidat të përbashkët për kryetar bashkie ose komune.

87. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të kompetencës së tij, përcaktuar në nenin 21, pika 9, të Kodit Zgjedhor, merr masa dhe organizon programe për edukimin zgjedhor të shtetasve, ku për pakicat kombëtare realizon programe të veçanta edukimi dhe trajnimi. Këto programe specifike synojnë forcimin e kulturës zgjedhore të shtetasit e pakicave kombëtare përmes dhënies së informacionit zgjedhor për të drejtën kushtetuese për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur edhe në gjuhët sipas përkatësisë së tyre etnike.

88. Për garantimin e të drejtave politike, civile dhe shoqërore për pakicat kombëtare, fushatat për edukimin zgjedhor u konceptuan me qasje sa më pranë tyre. Të gjitha materialet promociionale të prodhuara në gjuhën shqipe, u prodhuan edhe në gjuhët e tyre përkatëse. Konkretisht, postera dhe fletëpalosje informuese, sensibilizuese, ndërjegjësuëse, me informacion të plotë për llojin e zgjedhjeve, oraret e votimit procedurat e votimit, rëndësinë dhe vlerën e votës, rëndësinë e pjesëmarrjes në votime, për veprat e ndaluara në zgjedhje dhe veprimet e ndaluara në qendrën e votimit, u prodhuan në gjuhët maqedonase, greke, arumune, malazeze, romishte. Prodhimi dhe shpërndarja e këtyre materialeve u bë në bazë të informacionit të siguruar nga INSTAT për zonat dhe numrin e popullsisë së pakicave kombëtare. Materialet promociionale në gjuhë të pakicave kombëtare targetonin të gjitha kategoritë e zgjedhësve: të moshuar, të rinj, gra, persona me aftësi të kufizuara dhe zgjedhës për herë të parë. Ky aktivitet i KQZ-së kundrejt pakicave kombëtare pati vlerësim të misionëve vëzhguesë të OSCE-ODHIR, në raportet finale për vëzhgimin e zgjedhjeve.

Përfaqësimi i pakicave në kandidim për zgjedhjet e përgjithshme dhe zgjedhjet vendore dhe kandidatëve fitues që u përkasin pakicave<sup>23</sup>

89. Në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë në vitin 2013 u paraqitën lista shumëmemërore për të gjitha zonat zgjedhore parti politike që përfaqësojnë pakicat kombëtare: PBDNJ, PDIU, MEGA, AMIE. Sipas rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, fituan mandatet e deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, një kandidat i PBDNJ-së dhe katër të PDIU-së.

<sup>23</sup> Informacion i paraqitur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.



90. Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore 2015: Bashkitë ku PBDNJ-ja ka paraqitur lista shumemërore (gjithsej 36 bashki): Finiq; Fushë-Arrëz; Gjirokastër; Gramsh; Has; Himarë; Kavajë; Këlcyrë; Klos; Konispol; Korçë; Kuçovë; Kukës; Kurbin; Lezhë; Libohovë; Librazhd; Malësi e Madhe Maliq; Mat; Mirditë; Patos; Përmet; Pogradec; Poliçan; Përrenjas; Pukë; Roskovec Sarandë; Selenicë; Shkodër; Tiranë; Tropojë; Vlorë.

91. Bashkitë ku PBDNJ-ja ka paraqitur kandidatë për kryetar: Dibër, Dropull, Finiq, Himarë, Konispol.

- Bashkitë ku MEGA ka paraqitur lista shumemërore: Dropull, Finiq, Konispol, Sarandë.

- Bashkitë ku MEGA ka paraqitur kandidatë për kryetar: Dropull, Finiq.

- Bashkitë ku AMIE ka paraqitur lista shumemërore: Belsh, Berat, Bulqizë, Devoll, Elbasan, Kavajë, Korçë, Kuçovë, Lushnjë, Maliq, Pogradec, Përrenjas, Pustec, Shujak, Tiranë, Ura Vajurore.

92. Kanë fituar mandate për përfaqësimin në këshillat bashkiakë:

- PBDNJ-ja: Konsispol (një mandat), Mirditë (një mandat), Sarandë (një mandat), Dropull (tri mandate), Himarë (katër mandate), Finiq (gjashtë mandate).

- MEGA: Dropull (një mandat), Sarandë (një mandat), Pustec (shtatë mandate).

- AMIE: Pogradec (një mandat), Maliq (një mandat), Pustec (shtatë mandate).

- Kanë fituar mandatin e kryetarit të Bashkisë Finiq kandidati i MEGA-s, ndërsa mandatin e kryetarit të Bashkisë Pustec e ka fituar kandidati i koalicionit Aleanca për Shqipërinë Europiane, i cili është kryetar i Partisë AMIE.

Shërbimi civil

93. Ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij kanë si qëllim krijimin e një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të bazuar në meritë, integritet moral dhe paanësi politike. Parimet e pranimit në shërbimin civil janë: 1. Pranimi në shërbimin civil bazohet në parimet e shanseve të barabarta, meritës, aftësive profesionale e mosdiskriminimit dhe kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës transparent e të drejtë. 2. Procesi përzgjedhës bazohet në vlerësimin e aftësive profesionale të kandidatëve nëpërmjet një konkurrimi kombëtar,

që përfshin një testim të shkruar, një testim me gojë dhe çdo formë tjetër të përshtatshme të verifikimit të aftësive, si dhe vlerësimin e aftësive profesionale të kandidatit.

94. Lidhur me kërkesat e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil ky ligj përcakton se një kandidat duhet të plotësojë kërkesat e përgjithshme: a) të jetë shtetas shqiptar; b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar; c) të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur; ç) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse; d) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje; dh) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këtij ligji; e) të plotësojë kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit, përvojës dhe kërkesat e tjera të posaçme për kategorinë, klasën, grupin dhe pozicionin përkatës.

*Rekomandimi 15. Masat për të ndaluar praktikat diskriminuese dhe trajnimi i zyrtarëve të organeve ligjbatuese*

95. Legjislacioni i sistemit të burgjeve mbështetet në aktet ndërkombëtare dhe parimet bazë të trajtimit të personave me liri të kufizuar, të cilat garantojnë trajtimin me dinjitet dhe në respekt të të drejtave njerëzore të të paraburgosurve dhe të dënuarve në sistemin penitenciar, duke ndaluar çdo formë dhune të qëllimshme që cenon jetën apo shkakton denigrim dhe diskriminim të këtyre kategorive.

96. Ligji nr. 8328, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar, sanksionon parimet bazë të trajtimit të personave me liri të kufizuar, sipas të cilave të paraburgosurit dhe të dënuarit trajtohen pa njëanshmëri dhe pa diskriminim mbi bazë gjinie, race, ngjyre, përkatësie etnike, gjuhe, feje, shtetësie ose përkatësie në një grup të caktuar ose për çdo shkak tjetër që përbën diskriminim.

97. Ligji nr. 8328, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i amenduar në vitin 2014, sanksionon, gjithashtu, masat për parandalimin e dhunës dhe trajtimin e viktimave në sistemin penitenciar. Të paraburgosurve dhe të dënuarve, që kanë pasur përvoja të dhunës fizike, psikologjike ose seksuale, para ose gjatë qëndrimit në institucion, u ofrohen menjëherë masa mbrojtjeje, mbështetjeje dhe këshillime



ligjore, si dhe programe të individualizuara me qëllim rehabilitimin e tyre. Në raste të përdorimit të dhunës në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, autoritetet e institucionit, në çdo rast, mundësojnë fillimin e menjëhershëm të një hetimi të pavarur, nga strukturat dhe organet kompetente të ngarkuara me ligj, duke respektuar parimin e privatësisë, mbrojtjes dhe sigurisë personale.

98. Amendimet e miratuara në vitin 2014, në ligjin nr. 10 032, datë 11.12.2008, “Për policinë e burgjeve” parashikojnë rregullat e kontrollit, të përdorimit të forcës dhe mjeteve kufizuese, mbështetur në parimin e mosdiskriminimit.

99. Mbështetur në ligjin nr. 8328, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, të ndryshuar, monitorimi i situatës së personave me liri të kufizuar në sistemin e burgjeve bëhet nga Avokatit i Popullit, në kuadër të përmbushjes së rolit të tij si mekanizëm kombëtar për parandalimin e torturës, i cili kryen inspektime në burgje dhe jep rekomandimet përkatëse, nëpërmjet njësisë për parandalimin e torturës.

100. Rregullorja e re e Burgjeve, e miratuar me VKM-në nr. 437, datë 20.5.2015, krahas parimeve të mosdiskriminimit dhe trajtimit human, rregullon aspekte procedurale dhe parashikon mekanizma, që garantojnë trajtim sipas standardeve dhe monitorim të rregullt të sistemit të burgjeve. Kjo rregullore është mbështetur në rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi Rregullat Evropiane të Burgjeve, Rregullat e Kodit të Etikës të Stafit të Burgjeve etj.

101. Monitorime të pavarura kryhen nga organizma ndërkombëtarë si Komiteti për Parandalimin e Torturës (KPT), përfaqësi të organizmave ndërkombëtarë në vend, si OSBE-ja, si dhe OJF-të të vendit dhe të huaja. Këto organizata janë lejuar në çdo kohë të kryejnë inspektimin e ambienteve të paraburgimit dhe të burgjeve, si dhe të marrin kontakt direkt me personat e burgosur, në kushte konfidencialiteti. Gjithashtu, një mekanizëm i brendshëm inspektimi funksion në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.

102. Në masat parandaluese ndaj diskriminimit në burgje, një aspekt i rëndësishëm është rekrutimi i stafit profesional dhe trajnimi i tij. Procesi i trajnimit dhe i vlerësimit kryhen mbështetur në “Rregulloren e Qendrës së Trajnimeve”, një dokument i rëndësishëm i miratuar në muajin

nëntor 2014. Trajnimet janë kryer në partneritet me organizata ndërkombëtare dhe vendëse. Për periudhën 2011–2015 janë trajnuar gjithsej 4780 punonjës të rolit bazë dhe staf multidisiplinar. Në manualin “Komunikimi në burgje” hartuar në bashkëpunim me Komitetin Shqiptar të Helsinkit, është përfshirë edhe tema e “Mosdiskriminimit”. Kjo temë trajtohet rregullisht si pjesë e programit vjetor të Qendrës së Trajnimit të DPB-së, kryesisht me punonjësit e rolit bazë.

103. Ligji nr. 8328, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” i amenduar, sanksionon masat për mbrojtjen e privatësisë personale, korrespondencës, informacioneve të lidhura me shëndetin dhe rehabilitimin e personave me liri të kufizuar. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe institucionet penitenciare marrin masa për zbatimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale për personat e paraburgosur dhe të dënuar, pa dallim, duke garantuar një nivel sigurie të plotë gjatë përpunimit dhe ruajtjes së tyre.

104. Në çdo institucion penenciar funksion mekanizmi i kërkesë/ankesës, duke ruajtur dhe respektuar konfidencialitetin në çdo rast. Pas pranimit në institucion, i paraburgosuri apo i dënuari informohet nga Komisioni i Pritjes lidhur me të drejtën për të paraqitur kërkesa ose ankesa, me shkrim ose përjashtëmish me gojë, drejtuar personelit të institucionit, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Ministrit të Drejtësisë, Avokatit të Popullit, organizatave ndërkombëtare, OJF-ve vendëse dhe të huaja, gjykatës së vendit të ekzekutimit të vendimit penal, prokurorit pranë gjykatës së rrethit gjyqësor, si dhe personave të tjerë që vizitojnë institucionin.

105. Forcimi i partneritetit në funksion të promovimit dhe monitorimit të respektimit të të drejtave të personave me liri të kufizuar në sistemin e burgjeve është prioriteti i rëndësishëm i punës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPB) për parandalimin dhe eliminimin e çdo forme të diskriminimit mbi baza racore apo më gjerë. Për këtë qëllim, DPB-ja ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me 14 organizata joqeveritare. Dy prej këtyre organizatave i përkasin komunitetit egjiptian dhe kanë për objekt monitorimin e respektimit të të drejtave të të dënuarve dhe të paraburgosurve të këtij komuniteti në sistemin e burgjeve.



106. Individualizimi i trajtimit për personat me liri të kufizuar bëhet pa dallim, duke vlerësuar nevojat e tyre individuale psikologjike, shoqërore, gjinore dhe gjendjen shëndetësore të të dënuarve dhe të paraburgosurve.

107. Në vijim të masave të marra për krijimin e një sistemi efektiv rehabilitues për personat me liri të kufizuar, në 2014-ën është miratuar një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë mbi çështjet rehabilitimit dhe përgatitjes për lirim, duke krijuar mundësi për riintegrim të suksesshëm pas lirit të tyre.

108. Informacion specifik, grumbullohet dhe

Viti	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Total
Të mitur të trajtuar me shërbime (pas lirit)	8	7	9	11	9	10	54

110. Fletëpalosje janë përgatitur për njohjen e të dënuarve dhe të paraburgosurve me të drejtat e tyre, me qëllim rritjen e vetëdijes për mbrojtjen e të drejtave të tyre, veçanërisht në drejtëm të parandalimit të diskriminimit. Shërbimi shëndetësor në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale organizohet pa diskriminim. Të dënuarit dhe të paraburgosurit pa dallim, përfitojnë pa pagesë të gjitha shërbimet që ofron skema e sigurimit shëndetësor.

111. Një Memorandum Bashkëpunimi është nënshkruar midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë, në muajin korrik 2014. Kjo marrëveshje ka bërë të mundur ofrimin e shërbimeve të specializuara mjekësore në qendrat spitalore shtetërore dhe private jashtë sistemit të burgjeve, për të gjitha kategoritë e personave në sistemin e burgjeve.

112. Në çdo institucion zbatohet Protokollin i Stambollit për dokumentimin e rasteve të dhunës. Një dokument i rëndësishëm mbi politikën për grupet vulnerabël në sistemin e burgjeve, duke përfshirë edhe personat që u përkasin pakicave kombëtare zbatohet prej vitit 2015.

113. Në kuadër të respektimit të drejtave të njeriut është ngritur dhe funksionon në Drejtorinë e Policisë të Shtetit, Drejtoria e Standardeve Profesionale, e cila është në varësi direkt të Drejtorisë së Policisë së Shtetit dhe ka për detyrë kryerjen e kontrolleve/inspektimeve ndaj gjithë strukturave vendore dhe qendrore të policisë,

përdoret nga punonjësit socialë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, në mënyrë që të zhvillojnë programe për trajtimin e individualizuar për çdo individ, me qëllim përgatitjen e tyre për riintegrim në shoqëri.

#### *Praktikat e mira*

109. Në bashkëpunim me organizatat partnere është bërë e mundur, që për të miturit në konflikt me ligjin, të ofrohen shërbime të përkujdesjes pas lirit të tyre. Statistika mbi të miturit të komuniteteve egjiptiane dhe rome, të trajtuar gjatë periudhës 2011–2014, për të cilët janë ofruar shërbime të formimit profesional dhe të punësimit pas lirit, paraqiten në tabelën më poshtë:

lidhur me përmbushjen e detyrave sipas standardeve dhe procedurave të miratuara.

114. Pjesë e kontrolleve që kryhen nga kjo strukturë janë dhe ato për verifikimin e masave të marra dhe të zbatuara në trajtimin e personave të shoqëruar, të ndaluar dhe të arrestuar, respektimin e të drejtave ligjore dhe procedurale të tyre; verifikimin e trajtimit e ankesave të bëra nga kjo kategori personash për shkelje dhe abuzime të punonjësve të policisë me të drejtat e tyre (rrahje, keqtrajtime fizike etj.). Kjo strukturë ka kompetencë për të filluar hetimin disiplinor për personat përgjegjës dhe në përfundim jep masat disiplinore përkatëse (masa të lehta dhe të rënda disiplinore).

115. Për rastet kur janë kushtet dhe veprimet apo mosveprimet përbëjnë vepër penale, materialet i kalohen për ndjekje Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave, në Ministrinë e Punëve të Brendshme, i cili ka atributet e policisë gjyqësore për fillimin e procesit penal. Policia e Shtetit ka rritur ndjeshëm transparencën e punës për trajtimin dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe në veçanti për personat e privuar nga liria, duke vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me organizata të shoqërisë civile që mbrojnë të drejtat e njeriut, si:

- Marrëveshja e bashkëpunimit midis Policisë së Shtetit dhe Institutit Evropian të Tiranës me nr. 1627, datë 25.3.2013 dhe nr. 27, datë 25.3.2013, “Për përmirësimin e trajnimit dhe respektimit të të



drejtave të personave të privuar nga liria në ambientet e Policisë së Shtetit”.

- Marrëveshja e bashkëpunimit midis Policisë së Shtetit dhe Komitetit Shqiptar të Helsinkit me nr. 1626, datë 25.3.2013 dhe nr. 68, datë 26.3.2013, “Për përmirësimin e trajnimit dhe respektimit të drejtave të personave të privuar nga liria në ambientet e Policisë së Shtetit”.

- Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Qendrës Shqiptare të Rehabilitimit të Traumës dhe Torturës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit me nr. 106, datë 26.6.2013 dhe nr. 3512, datë 8.7.2013, “Për parandalimin e torturës, keqtrajtimeve dhe rritjen e nivelit të respektimit të lirive dhe të drejtave të personave që privohen nga liria në ambientet e Policisë së Shtetit”.

- Marrëveshja e bashkëpunimit midis Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me nr. 469/2, datë 17.1.2012 dhe nr. 23, datë 16.1.2012.

116. Përfaqësues të këtyre organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore janë pajisur me leje hyrjeje provizore për të kryer vizita monitoruese në ambientet e dhomave të sigurisë dhe ato të shoqërimit në drejtoritë dhe komisaritet e policisë në fushën e respektimit dhe garantimit të drejtave të kësaj kategorie personash.

117. KMD-ja ka vlerësuar si efektive trajnimin, si të stafit të institucionit për të rritur kapacitet e tyre për trajtimin e rasteve të diskriminimit racial, ashtu edhe trajnimin e stafit të policisë lidhur me LMD-në. Me mbështetjen e UNDP-së janë trajnuar punonjësit e zyrës së KMD-së dhe është përgatitur edhe një manual për trajtimin e rasteve të diskriminimit për shkak të racës. Nga ana tjetër, KMD-ja ka hartuar një modul lidhur me barazinë dhe mosdiskriminimin për përfshirjen e saj në kurikulat e trajnimit të qendrës së formimit policor dhe ka përgatitur një kalendar për trajnime.

118. Për parandalimin e dhunës dhe keqtrajtimeve ndaj personave që shoqërohen, ndalohen dhe arrestohet (përfshi dhe ata të komuniteteve rome, egjiptiane) nga ana e Policisë së Shtetit janë marrë e zbatuar këto masa:

#### *Planifikimi e zhvillimi i trajnimeve*

119. Në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në marrëveshjet e bashkëpunimit midis Policisë së Shtetit dhe disa organizatave të shoqërisë civile për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, nga OJQ/OJF

janë zhvilluar trajnime me synim rritjen e nivelit tekniko – profesional të personelit për zbatimin e akteve ligjore ndërkombëtare dhe ato të vendit që sanksionojnë dhe mbrojnë të drejtat e njeriut, të personave të privuar nga liria në ambientet e policisë, parandalimin e torturës, ushtrimit të dhunës dhe keqtrajtimeve ndaj kësaj kategorie personash etj.

*Zhvillimi i trajnimeve të specializuara me personelin policor, me fokus njohjen e akteve ndërkombëtare dhe atyre vendës që sanksionojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe respektimi e garantimi i tyre në veprimtarinë e Policisë së Shtetit*

- Nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) në bashkëpunim me Departamentin e Sigurisë Publike, gjatë muajit qershor 2014 janë zhvilluar trajnime njëditore, me pesë grupe mësimore me 26 pjesëmarrës për çdo grup mësimor (*gjithsej 130 punonjës policie*), me punonjës të strukturave të rendit publik, krimeve të rënda dhe krimin të organizuar. Tematika e këtij trajnimi ka qenë: “Parandalimi i torturës dhe keqtrajtimit në komisaritet e policisë”.

- Në muajin qershor 2014, nga ekspertë të Këshillit të Evropës është zhvilluar trajnim me grup mësimor prej 30 punonjësish të policisë të strukturave të rendit publik, krimeve të hapura, krimeve të rënda dhe të organizuar, të nivelit të parë të drejtimit dhe atij zbatues, me kohëzgjatje dyditore, me tematikë “Trajtimi i përshtatshëm i të ndaluarve/arrestuarve në ambientet policore”.

- Nga ana e organizatës Instituti Evropian i Tiranës, gjatë periudhës qershor 2014 – shkurt 2015 janë zhvilluar trajnime në 12 Drejtoritë e Policisë së Qarqeve, me 12 grupe mësimore me kohëzgjatje dyditore për çdo grup me pjesëmarrjen e 20 punonjësve të policisë për çdo grup mësimor (*gjithsej 200 punonjës policie*). Tematika e këtij trajnimi ka qenë “Parandalimi i torturës dhe respektimi i të drejtave të njeriut, të shoqëruarve, ndaluarve, dhe arrestuarve në ambientet e Policisë”.

- Trajnim në vitin 2015 i tri grupeve mësimore zhvilluar nga Departamenti për Sigurinë Publike, në ambientet e Akademisë së Sigurisë, me nga 25 punonjës policie për çdo grup, me kohëzgjatje treditore për çdo grup, me punonjës të strukturave të rendit publik të nivelit zbatues dhe atij të parë të drejtimit. Një nga ditët e trajnimit i është kushtuar njohjes së përcaktimeve që ka bërë ligji nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, lidhur me





shoqërimin e personave, rastet e shoqërimit, të drejtat që ka kjo kategori personash etj.

- Trajnim i tri grupeve mësimore zhvilluar nga Departamenti për Sigurinë Publike me pjesëmarrjen e 25 punonjësve për çdo grup, me kohëzgjatje treditore për çdo grup mësimor. Trajnimi ka pasur si tematikë “Rregullat dhe procedurat standarde për hedhjen e administrimin e të dhënave për personat e shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar në sistemin ADAM”, zhvilluar gjatë vitit 2016.

- Trajnim i tri grupeve mësimore zhvilluar nga Departamenti për Sigurinë Publike me pjesëmarrjen e 25 punonjësve për çdo grup, me kohëzgjatje treditore për çdo grup mësimor. Trajnimi ka pasur si tematikë: “Përcaktimet ligjore për shoqërim, rastet e shoqërimit, trajtimi i të shoqëruarve dhe përcaktimet e bëra në procedurën standarde të punës: rregullat teknike të shoqërimit në polici”, e rishikuar dhe miratuar me urdhrin nr. 306, datë 31.3.2016, të DPP-së së shtetit. Ky trajnim është zhvilluar gjatë vitit 2016.

- Trajnim dyditor me të gjithë personelin policor të strukturave vendore dhe qendrore të policisë lidhur me njohjen e kërkesave të Rregullores së Policisë së Shtetit miratuar me VKM-në nr. 750, datë 16.9.2015. Ky trajnim është zhvilluar gjatë vitit 2016.

#### *Monitorimi i veprimtarisë së policisë*

Përfaqësues të policisë kanë zhvilluar takime të ndryshme me anëtarë të minoriteteve ku kanë shprehur angazhimin e Organizatës së Policisë për çdo lloj mbështetjeje dhe bashkëpunimi. Ndër masat e tjera mund të përmendim:

- Planifikimi dhe kryerja e inspektimeve dhe kontroleve nga ana e strukturave qendrore të policisë (departamentet sipas shërbimeve dhe Drejtoria e Standardeve Profesionale) ndaj atyre të policisë vendore për përmbushjen e detyrimeve në respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar, ndaluar dhe të arrestuar.

- Kryerja e inspektimeve dhe vizitave monitoruese nga institucione apo struktura të tjera shtetërore jashtë Policisë së Shtetit dhe institucione të pavarura, ndaj veprimtarisë së strukturave të policisë.

*Rekomandimi 16. Informacione rreth masave për të garantuar të drejtën efektive për arsimim të fëmijëve që u përkasin pakicave*

120. Kuadri ligjor në fushën e arsimit garanton të drejtën e arsimimit në gjuhën amtare për personat që u përkasin pakicave kombëtare, duke mundësuar funksionimin e shkollave dhe klasave ku mësohet gjuha amtare, historia dhe kultura e vendit të origjinës. Kurikula e arsimit bazë, u jep mundësi të gjitha shkollave që të zhvillojnë edhe një kurikul në bazë shkolle. Për këtë qëllim, të gjitha klasat kanë në dispozicion orë të lira në planin mësimor, ku vetë pjesëtarët e pakicave kombëtare, nëpërmjet bordeve të prindërve në shkolla, vendosin lëndët që do të zhvillojnë. Kjo krijon mundësinë për pakicat që në programet mësimore të futet si lëndë me zgjedhje gjuha e tyre dhe në këtë rast, drejtoria e shkollës siguron programin dhe materialet e duhura për zhvillimin korrekt të mësimimit.

#### *Tekstet shkollore*

121. Prej vitit 2011 janë rishikuar 96 kurikula lëndore (klasa 1-9) për gjuhën shqipe, lëndët shoqërore, artistike dhe sportive, për tematikat mbi historinë dhe kulturën rome. Rreth 300 mësues (Korçë, Gjirokastrë) janë informuar për integrimin e gjuhës, kulturës, traditës rome dhe egjiptiane në kurikulat e arsimit bazë. U hartua dhe u botua paketa e moduleve “Historia, kultura rome dhe përfshirja e saj në kurikulën shkollore”.

122. Bazuar në udhëzimin e Ministrisë së Arsimit, “Për arsimimin në gjuhën amtare të personave të pakicave”, në shkollat e pakicës greke përdoren 11 tekste të mirëfillta në gjuhën greke, ndërsa 46 tituj përkthime nga gjuha shqipe. Edhe në shkollat e pakicës kombëtare maqedonase struktura e teksteve shkollore që përdoren është e njëjtë; 11 tekste të mirëfilltë të gjuhës maqedonase dhe 46 të tjera, përkthime nga gjuha shqipe. Kostoja e botimit dhe e shpërndarjes së teksteve shkollore për shkollat e pakicave kombëtare, për arsye të tirazhit të vogël, rezulton shumë e lartë. Në shkollat e pakicës greke mësohet gjuha greke nga klasa e parë deri në klasën e 12-të, janë futur edhe lëndët e reja në arsimin 9-vjeçar, si: “Njohuri për historinë e popullit grek”, “Gjeografia e Greqisë”, “Vendlindja”.

123. Bazuar në urdhrin e ministrit të Arsimit dhe Shkencës, nr. 530, datë 26.10.2011, “Për miratimin e paketës informuese Altertekst 2012”, një nga kriteret për vlerësimin dhe miratimin e teksteve ka qenë pasqyrimi në to i barazisë gjinore, racore, kombëtare, e fetare dhe i parimeve



demokratike të mosdiskriminimit. Për të realizuar kërkesat e shkollave të minoriteteve me të gjithë numrin e teksteve mësimore që nevojiten, në vitin 2012 nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës u krijua shtëpia botuese BOTEM që merret vetëm me këto tekste.

124. Bazuar në marrëveshjet e përbashkëta ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë, të gjithë nxënësve të pakicës kombëtare greke, që mësojnë në shkollat publike të Drejtorisë Arsimore Rajonale (DAR) Gjirokastrë (316 nxënës), Zyrës Arsimore (ZA) Delvinë (134 nxënës), ZA Sarandë (356 nxënës), u janë dhënë tekstet shkollore falas. Kostoja e këtyre teksteve është shumë e lartë për shtetin shqiptar për shkak të tirazhit tepër të ulët që ato kanë. Numri i teksteve që përdoren në shkollat ku mësojnë pakicat kombëtare greke, ndër to tituj në gjuhën greke, tituj të përkthyer, tituj të lëndëve të veçanta që zhvillohen vetëm në shkollat e kësaj kategorie, është tepër i lartë, thuhet në një raport të arsimit bazë shqiptar. Plani dhe programet mësimore janë hartuar në bashkëpunim me mësuesit e pakicës kombëtare greke dhe të specialistëve të DAR Gjirokastrë. Një pjesë e këtyre mësuesve janë autorë të teksteve shkollore që përdorin fëmijët e kësaj pakice. Në shkollat e minoritetit grek japin mësim 98 mësues për 777 nxënës gjithsej, pra një mësues për rreth 8 nxënës, ndërkohë që ky raport në shkallë kombëtare është 1:20.

125. Lidhur me nxënësit e pakicës maqedonase në juridiksionin e DAR Korçë, komuna Liqenas (135 nxënës gjithsej në arsimin 9-vjeçar dhe të mesëm), dhe komunat Goricë e Madhe e Goricë e Vogël (105 nxënës në arsimin 9-vjeçar), struktura e titujve është e njëjtë me atë të pakicës greke. Janë në dorën e nxënësve 11 titujt e mirëfilltë në gjuhën maqedonase, por mungojnë tërësisht titujt përkthime dhe ata të veçantë për të mësuar gjuhën shqipe. Aktualisht janë ofruar tekste shkollore falas për nxënësit e pakicave kombëtare: Sarandë, për 279 nxënës; Gjirokastrë, për 271 nxënës; Korçë, për 129 nxënës; si dhe në Delvinë, për 121 nxënës. Nxënësve të pakicave u sigurohen tekstet e lëndëve që zhvillohen në gjuhën shqipe.

126. Gjendja e teksteve të pakicave kombëtare, sipas programit mësimor më 1 shtator 2013, ka qenë: Nga 66 tituj në gjuhën amtare maqedonase u prodhuan 32 tituj, mungonin 34 tituj. Lidhur me situatën e krijuar për mungesën e teksteve,

Ministria e Arsimit dhe Sportit mori masa për hartimin dhe botimin e teksteve për pakicat kombëtare maqedonase dhe për vitin 2013 u botuan 15 tituj të rinj. Gjithashtu, për herë të parë gjatë vitit shkollor 2013–2014, u botuan dhe u shumëfishuan 17 tekste të përkthyer nga gjuha shqipe në gjuhën maqedonase. Për vitin shkollor 2014–2015 është dyfishuar fondi për tekstet e pakicave kombëtare. Nga Ministria e Arsimit dhe Sportit janë marrë të gjitha masat në drejtim të mundësimit të teksteve shkollore dhe infrastrukturës së institucioneve arsimore aty ku jetojnë fëmijët e minoritetit maqedonas, si rasti i Bashkisë së Pusteqit, po bashkëpunohet ngushtë edhe me pushtetin vendor.

127. Nga viti 2015, tekstet shkollore për pakicat kombëtare plotësojnë standardet evropiane. Për këtë objektiv po punohet për përkthimin e teksteve të reja në gjuhën amtare të minoriteteve, si edhe përshtatja e disa teksteve në lidhje me dhënien e informacionit të saktë për pakicat kombëtare në vendet përkatëse. Në dokumentin e “Strategjisë së zhvillimit të arsimit parauniversitar, 2014–2020”, një ndër veprimtaritë e parashikuara në planin për zbatimin e saj është edhe vijimi i pajisjes me tekstet shkollore falas për pakicat kombëtare, si dhe ofrimi i teksteve shkollore, për të siguruar një mësimdhënie cilësore për pakicat kombëtare, sipas standardeve bashkëkohore.

Kualifikimi i mësuesve

128. Për formimin e mësuesve që punojnë me nxënësit e pakicave kombëtare, funksionon Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike pranë Universitetit të Tiranës, si dhe Departamenti i Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek pranë universitetit “Eqrem Çabej” të Gjirokastrës. Në shkollën e mesme pedagogjike të Gjirokastrës funksionon dega “Mësuesi” për pakicën greke, ku përgatiten mësues për shkollat e pakicës kombëtare greke.

129. MAS-i, në vitet 2010–2014, ka mbështetur me mësues ndihmës rreth 450 fëmijë romë dhe egiptianë për asistim detyrash shtëpie, përgatitje për provimet e lirisimit etj., duke i organizuar në klasa suplementare/përforcuese për të frenuar braktisjen e shkollës nga këta fëmijë, në Njësinë Bashkiake nr. 4, zona Allias, përkatësisht në shkollat 9-vjeçare “Bajram Curri” dhe “Ramazan Jaranj”. Gjithashtu është parashikuar trajnimi i mësuesve që u japin mësim nxënësve të pakicave



kombëtare për kurikulën e re, klasa I, II, V, VI për të mësuarit me kompetenca për 2016-ën.

130. Drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore në shkollat dhe klasat që frekuentohen nga fëmijët romë, kanë emëruar mësues me përvojë, të përkushtuar në punë dhe me etikë komunikimi. Nga rreth 1000 mësues që punojnë me nxënës romë, mbi 800 prej tyre janë me arsim të lartë dhe mbi 140 me arsim të mesëm pedagogjik me mbi 20 vjet punë. Në shkollat e komuniteteve romë dhe egjiptiane funksionojnë 63 borde. Në këto borde janë anëtarë 98 prindër romë dhe egjiptianë. Për frekuentimin dhe përparimin e nxënësve në procesin mësimor janë ngritur dhe po funksionojnë në shkolla grupe mbështetëse me pjesëmarrjen e mësuesit kujdestar, psikologut, bordit të shkollës, qeverisë së nxënësve dhe pjesëtarëve nga komuniteti rom.

131. Në shkollën e mesme pedagogjike të Gjirokastrës funksionon dega “Mësuesi” për pakicën greke, ku përgatiten mësues për shkollat e pakicës kombëtare greke. Në universitetin “Eqrem Çabej” në Gjirokastrë funksionon dega e gjuhës greke. Gjithashtu, në fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës funksionon dega e gjuhës greke. Gjuha maqedonase studiohet si lëndë me zgjedhje në vitin e dytë dhe të tretë në Departamentin e Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës. Lënda ka 4 kredite (40 orë) për çdo semestër, pra gjithsej 16 kredite për dy vite studimi.

132. Të drejtat e njeriut janë pjesë e paketës kurikulare të arsimit parauniversitar dhe zënë një vend të rëndësishëm:

- Në standardet e të nxënësve në arsimin parauniversitar.

- Në kurikulën zyrtare të lëndës së Edukimit qytetar, si dhe në arsimin parauniversitar, në klasat 1–12-të.

- Çështjet e DNJ-së trajtohen në tekstet shkollore në lëndën e edukimit qytetar dhe në veprimtaritë e ndryshme që zhvillohen në shkollë, në zbatim të objektivave kurikularë.

- DNJ-ja trajtohen edhe në kuadrin e veprimtarive kroskurikulare (ndërlëndore) dhe atyre ekstrakurikulare (veprimtaritë jashtëshkollore). Botime të shumta edhe nga OJF-të mbështesin zhvillimin e këtyre veprimtarive.

- Edukimi i të drejtave të njeriut është bërë pjesë e programeve të shumta të unifikuara të trajnimit e

kualifikimit të mësuesve të edukimit qytetar.

Aksesi i romëve në arsimim

133. Kuadri ligjor dhe nënligjor ekzistues mbështet arsimimin e fëmijëve nga komuniteti rom dhe egjiptian.

- Vendimi nr. 672, datë 7.8.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, bursat e shtetit dhe pagesat e nxënësve e të studentëve në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2013–2014”, përfitojnë bursë me vendime të këshillave të bashkive apo komunave të gjithë nxënësit apo studentët romë dhe egjiptianë.

- Sipas vendimit nr. 565, datë 27.6.2013, të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, për vitin akademik 2013–2014”, pika 9, fëmijët romë, ballkano-egjiptianë, përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit.

- Vendimi nr. 517, datë 1.8.2015 të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, për vitin akademik 2015–2016”, fëmijët romë, ballkano-egjiptianë, përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”. Për vitin akademik 2015–2016 20, kuotat për romët dhe ballkano-egjiptianët ishin 20. Këtë vit akademik, për kuotat e ciklit të dytë, është parashikuar një rritje prej 33% për kategoritë e veçanta. Gjithashtu, këta kandidatë përfitojnë 50% reduktim tarife për ciklin e dytë dhe 100% për ciklin e parë.

- Udhëzimi i MAS-it nr. 21, datë 8.8.2014, “Për rritjen e ndjekjes së arsimit parashkollor nga fëmijët romë”.

- Udhëzimi i MAS-it nr. 38, datë 7.10.2014, “Për kriteret e mësuesit ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”.

- Urdhri i përbashkët (MAS, MPB dhe MSH) nr. 2, datë 5.1.2015, “Për miratimin e rregullores për zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, datë 2.8.2013, “Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor”.



- Në udhëzimin nr. 23, datë 8.8.2014, “Për vitin shkollor 2014–2015 në sistemin arsimor parauniversitar”, kreu II pika 1/c, drejtoritë dhe zyrat arsimore rajonale udhëzohen për plotësimin me përparësi të nevojave dhe kërkesave për arsimimin në gjuhën amtare të pakicave kombëtare. Duke filluar nga viti shkollor 2011–2012 edhe fëmijët e komunitetit rom, në arsimin e detyruar, i marrin tekstet shkollore falas në shkollën ku janë të regjistruar. Gjatë vitit shkollor 2014–2015, 3446 nxënës romë morën tekstet falas.

- Për vitin shkollor 2015–2016, tekstet shkollore falas i morën dhe nxënësit egjiptianë, në zbatim të VKM-së nr. 707, datë 28.8.2015, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 107, datë 10.2.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar”, të ndryshuar.

134. Ofrimi i shërbimit arsimor për komunitet rome e egjiptiane dhe krijimi real i mundësive të barabarta në të gjitha nivelet e sistemit arsimor, vitet e fundit bazohet veçanërisht në “Planin kombëtar të veprimit për dekadën e përfshirjes së romëve, 2009–2015”, si dhe në plotësimin e rekomandimeve për përfshirjen e komunitetit rom, në kuadër të integritetit të Shqipërisë në BE. Plani i veprimit përmban: objektiva të matshëm, statistikën e komunitetit rom, të dhëna për fëmijët romë 3–6 vjeç. Çdo DAR/ZA krahas dokumentacionit për treguesit dhe progresin në kuadër të nismës, bashkëpunon me njësitë bazë të qeverisjes vendore, në rastet: kur prindi nuk ka dokumentacionin e nevojshëm; kur kopshtet dhe shkollat nuk kanë të regjistruar fëmijë romë; për sigurimin e një përkujdesjeje të posaçme nga shërbimi psikosocial për fëmijët romë që ndjekin kopshtin; për sigurimin e transportit për fëmijët romë të moshës parashkollore.

135. Me synim përmirësimin e cilësisë së shërbimit në shkolla, vazhdon puna e diferencuar dhe mësimdhënia shtesë për nxënësit që vijnë nga komunitetet rome me modulet e përgatitura nga IZHA-ja; vijon organizimi i trajnimeve në shkolla me prindërit e fëmijëve romë, me fokus: Ndihmë për mësimin e gjuhës shqipe. Është përmirësuar sistemi i mbledhjes së të dhënave statistikore për evidentimin e nxënësve që braktisin shkollën që vijnë nga komuniteti rom; janë identifikuar zonat ku mund të funksionojë shansi i dytë (duke pasur

parasysh numrin e fëmijëve që kanë braktisur shkollën sipas grup-moshave); është hartuar dokumentacioni i qartë për nxënësit që ndjekin çdo formë arsimimi, me synim integrimin e tyre në shkolla.

136. Nëpërmjet bashkëpunimit ndërinstitucional është realizuar pilotimi i një qasjeje të integruar të “shkollës me ushqim”. Në këtë kuadër, shkolla “Naim Frashëri” në Korçë, në vitin shkollor 2012–2013, u mbështet me 335 bursa/kuota ushqimore për nxënësit romë dhe egjiptianë. Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 665, datë 7.8.2013, “Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit”, kjo mbështetje vazhdon edhe gjatë vitit shkollor 2013–2014. Duke filluar nga viti 2009, në çdo vit akademik, me vendim të Këshillit të Ministrave pranohen nga 20 studentë romë dhe egjiptianë në çdo nivel studimesh, 100 studentë çdo vit (bachelor me kohë të plotë e kohë të pjesshme, master profesional me kohë të plotë e kohë të pjesshme dhe master shkencor). Tarifa e shkollimit të studentëve romë dhe egjiptianë, po ashtu, caktohet çdo vit me Vendim të Këshillit të Ministrave dhe është në nivelet 50%–100% bursë.

Në vitin shkollor 2013–2014, numri i fëmijëve romë, pjesë e sistemit arsimor parauniversitar ishte në total 4219, në krahasim me 4085 që ka qenë në vitin shkollor 2012–2013. Në vitin shkollor 2014–2015, janë regjistruar në arsimin e detyruar 4437 nxënës romë dhe në arsimin e mesëm 408 nxënës romë.

137. Memorandumi i Bashkëpunimit nr. 254/1, nënshkruar në datën 21.11.2014, ndërmjet MAS-it dhe qendrës ARSIS (organizatë shoqërore e përkrahjes së të rinjve) në partneritet me MAS-in dhe MMSR-në, me mbështetjen e Roma Education Fund (REF), ka nisur zbatimin e projektit me titull “Përmirësimi i arritjeve arsimore të të rinjve romë dhe egjiptianë (R/E) të klasës së nëntë dhe ndjekja e tyre deri në diplomimin e arsimit të mesëm”. Në kuadër të këtij projekti, nxënësve romë dhe egjiptianë të klasave të 9-ta po u shpërndahen 80 bursa sociale (30 euro/muaj për çdo nxënës të përzgjedhur, 300 euro/vit).

138. MAS-i dhe MMSR-ja, në partneritet me ARSIS-in (organizatë shoqërore e përkrahjes së të rinjve) dhe mbështetjen e Roma Education Fund (REF), ka nisur zbatimin e projektit me titull “Përmirësimi i arritjeve arsimore të të rinjve romë dhe egjiptianë të klasës së nëntë dhe ndjekja e tyre



deri në diplomimin e arsimit të mesëm”. Në kuadër të këtij projekti, nxënësve romë dhe egjiptianë të klasave të 9-ta u janë shpërndarë 80 bursa sociale (30 euro/muaj për çdo nxënës të përzgjedhur, 300 euro/vit).

139. Gjatë vitit akademik 2013–2014, janë identifikuar 93 mësues romë dhe egjiptianë të diplomuar për mësuesi, prej të cilëve janë punësuar në sistem 86% e tyre (80 mësues): 10 në arsimin parashkollor, 21 në klasat I–V; 35 në klasat VI–IX (1 egjiptian drejtor shkolle në Dibër) dhe 14 në arsimin e mesëm dhe të lartë. Të 35 mësuesit romë janë të punësuar sipas profilit të diplomës që zotërojnë. Duke filluar nga viti shkollor 2011–2012, fëmijët romë në arsimin e detyruar i marrin tekstet shkollore falas në shkollën ku janë të regjistruar. Numri i nxënësve romë që kanë përfituar tekste falas për vitin akademik 2013–2014 ishte 3370 dhe për vitin akademik 2014–2015 është 3219 nxënës. Tekstet shkollore falas përfitohen nga mbi 3200 nxënës romë Duke filluar nga viti 2009 kuotat e përcaktuara me VKM-në për pranimet në universitet për studentë romë/egjiptianë është 20 për çdo nivel studimi.

140. Në lidhje me regjistrimin në gjendjen civile, gjatë vitit 2014, janë zhvilluar takime në 12 qendra rrethesh, ku ka përqendrimë më të mëdha të familjeve rome. Qëllimi ishte identifikimi i rasteve të paregjistruara dhe përcaktimi i tyre për mënyrën e zgjidhjes administrative gjyqësore. Nga ana tjetër, ka vazhduar në mënyrë të rregullt procesi i regjistrimit të rasteve të identifikuar më parë. Nga ky proces, gjatë vitit 2014 janë regjistruar 147 fëmijë, si regjistrime të vonuara.

141. Në kuadër të programit “Shkolla si qendër komunitare” janë ndërmarrë një sërë masash për uljen e fenomenit të braktisjes së shkollës dhe për përmirësimin e situatës arsimore të komunitetit

rom dhe egjiptian. Në bashkëpunim me pushtetin vendor, një ndër qasjet e suksesshme është organizimi i klasave suplementare/përforcuese për të frenuar braktisjen e shkollës nga fëmijët romë. MAS-i ka marrë një sërë masash, që synojnë: Regjistrimin dhe frekuentimin e fëmijëve në arsimin parashkollor dhe atë të detyruar; Eliminimin e qëndrimeve përjashtuese dhe inferiore ndaj romëve në komunitetin shkollor; Ruajtja dhe zhvillimi i identitetit kulturor të nxënësve dhe studentëve të pakicës rome. Me synimin për të përmirësuar kualifikimin e mësuesve në drejtim të çështjeve me ndjeshmëri të lartë, si diversiteti etnik, në kuadër të “Programit për integrimin e historisë dhe kulturës rome” në kurikulum ka pasur edhe ndërhyrje në programin “Përgatitja e trajnerëve në edukim”.

142. Ministria e Arsimit dhe Sportit po i jep përparësi dhe edukimit të fëmijëve romë që në fëmijërinë e hershme. Për këtë, në zbatim të nismës “Çdo fëmijë rom në kopsht”, të gjitha institucionet arsimore parauniversitare kanë hartuar një plan veprimi për rritjen e frekuentimit të kopshtit dhe integrimin e fëmijëve romë në kopshte. Përdorimi i broshurës “Një shkollë për të gjithë” synon përfshirjen e fëmijëve romë/egjiptianë dhe me vështirësi të tjera në edukim. Në kuadër të “Ditës ndërkombëtare të romëve” janë organizuar një sërë aktivitete në qytete të ndryshme të Shqipërisë, me synim ndërgjegjësimin e opinionit publik për këtë shtresë të popullsisë me moton: “Paqe dhe zhvillim për të gjithë romët në botë”. Në pushimet verore 2013, në 11 DAR dhe 7 ZA, në bashkëpunim me UNICEF-in dhe shoqata të tjera, u hapën dhe funksionuan 60 kampe verore, ku nga 2677 fëmijë gjithsej, 722 ishin romë dhe egjiptianë.

Të dhëna statistikore për fëmijët romë brenda sistemit arsimor 2011–2015:

Viti shkollor	Arsimi parashkollor		Arsimi bazë		Arsimi i mesëm i lartë		Gjithsej në arsimin parauniversitar	
	Gjithsej	±	Gjithsej	±	Gjithsej	±	Gjithsej	±
2009–2010	681		2866		29		3576	
2010–2011	516	- 165	2888	+ 20	94	+ 65	3498	- 78
2011–2012	560	+ 44	3435	+ 547	113	+ 19	4108	+ 610
2012–2013	664	+ 104	3231	- 204	200	+ 87	4095	- 13
2013–2014	619	- 45	3370	+ 139	176	- 24	4165	+ 70
2014–2015	921	+302	4437	+ 1067	422	+ 246	5780	+1615



143. Statistikat paraqesin tregues pozitivë në realizimin e synimeve dhe objektivave të shpallur në fushën e arsimit.

- Në vitin shkollor 2012–2013, në arsimin e mesëm, vijuan mësimet 200 nxënës romë (ose 87 të rinj romë më shumë se një vit më parë).

- Në vitin shkollor 2013–2014, numri i fëmijëve romë pjesë e sistemit arsimor parauniversitar ishte 4165, në krahasim me 4095 në vitin shkollor 2012–2013.

- Në vitin shkollor 2014–2015, në arsimin parauniversitar janë regjistruar: 5780 fëmijë dhe nxënës romë (1615 më shumë në krahasim me vitin e kaluar shkollor), në arsimin parashkollor: 921 fëmijë romë, në arsimin bazë: 4437 nxënës romë (4371 në arsimin publik; 66 në arsimin jopublik), në arsimin e mesëm: 422 nxënës romë (408 në arsimin publik; 14 në jopublik).

- Nga 917 fëmijë gjithsej që ndoqën “Shansin e dytë”, 625 prej tyre janë romë dhe egjiptianë.

- Në rregulloret e brendshme dhe në planet e punës vjetore të drejtorive të shkollave janë përcaktuar objektiva të matshëm për gjithpërfshirjen dhe, mbi bazën e këtyre treguesve, bëhen analiza dymujore me prindërit, bordin e shkollës dhe komunitetin.

- DAR-të/ZA-të, gjatë vitit 2013 trajnuan 563 mësues për këshillimin e prindërve romë dhe zhvilluan 442 fushata ndërgjegjësuese me pjesëmarrjen e mbi 1500 prindërve romë.

- Për respektimin e kulturave brenda shkollës dhe për harmonizimin e interesave të nxënësve, drejtoritë e shkollave, në bashkëpunim me fëmijët, prindërit dhe komunitetin, planifikojnë aktivitete gjithëvjetore ndërkulturore me prindër dhe nxënës romë dhe jo romë. Gjatë vitit 2013, në 96 shkolla u organizuan 602 aktivitete ndërkulturore me pjesëmarrjen e mbi 4800 nxënësve.

- DAR-të/ZA-të kanë emëruar mësues me përvojë, të përkushtuar në punë dhe me etikë komunikimi në shkollat dhe klasat që frekuentohen nga fëmijët romë. Nga rreth 1000 mësues që punojnë me nxënës romë, mbi 800 prej tyre janë me arsim të lartë dhe mbi 140 me arsim të mesëm pedagogjik me mbi 20 vjet punë.

- Në shkollat e komuniteteve rome dhe egjiptiane funksionojnë 63 borde. Në këto borde janë anëtarë 98 prindër romë dhe egjiptianë.

*Rekomandimi 20. Informacione rreth bashkëpunimeve me Shtete të tjera dhe organizata për adresimin e problemeve të minoriteteve dhe komunitetit rom*

144. Në lidhje me bashkëpunimin ndërshtetëror, qeveria e Shqipërisë i vazhdon përpjekjet e saj për të bashkëpunuar me shtete të tjera në Rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe më gjerë në adresimin e problemeve të minoritetit rom në Shqipëri. Gjatë viteve 2012–2014 janë mbajtur një sërë tryezash të rrumbullakëta ndërqeveritare për adresimin e çështjeve të romëve në nivel rajonal dhe më gjerë.

145. Gjithashtu, në kuadër të bashkëpunimit ndërshtetëror në fushën e arsimit të minoriteteve, ekziston “Marrëveshja për bashkëpunim në fushën e shkencës midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Maqedonisë” (miratuar me VKM-në nr. 781, datë 22.9.2015), nënshkruar në datën 2 korrik 2015. Neni 3 i kësaj marrëveshjeje parashikon bashkëpunim mes palëve, me qëllim arsimimin e pakicave kombëtare në gjuhën amtare, në përputhje me legjislacionin vendës, por duke marrë në konsideratë edhe Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare.

146. Ministria e Arsimit dhe Sportit i ka vënë në dispozicion palës greke të gjitha tekstet shkollore shqiptare të historisë, gjeografisë, gjuhës dhe letërsisë dhe ekonomisë për vlerësimin nga ana e tyre, në përputhje me protokollin e takimit të 2-të të Komitetit të Përbashkët Shqiptaro-Grek, mbajtur në Tiranë, më 19 nëntor 2014. Pala greke, nga ana e saj ka vënë në dispozicion formatin elektronik të teksteve të saj të historisë, gjeografisë, kulturës, ekonomisë.

147. Gjithashtu ekziston “Marrëveshja për bashkëpunim në fushën e shkencës midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Maqedonisë” (miratuar me VKM-në nr. 781, datë 22.9.2015), nënshkruar në datën 2 korrik 2015. Neni 3 i kësaj marrëveshjeje parashikon bashkëpunim mes palëve, me qëllim arsimimin e pakicave kombëtare në gjuhën amtare, në përputhje me legjislacionin vendës, por duke marrë në konsideratë edhe Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare.



148. Në lidhje me komunitetin rom, memorandum i bashkëpunimit nr. 254/1 prot., nënshkruar në datën 21.11.2014 ndërmjet MAS-it dhe qendrës ARSIS (organizatë shoqërore e përkrahjes së të rinjve). ARSIS-i (organizatë shoqërore e përkrahjes së të rinjve) në partneritet me MAS-n dhe MMSR-në, me mbështetjen e Roma Education Fund (REF), ka nisur zbatimin e projektit me titull: “Përmirësimi i arritjeve arsimore të të rinjve romë dhe egjiptianë (R/E) të klasës së nëntë dhe ndjekja e tyre deri në diplomimin e

arsimit të mesëm”. Në kuadër të këtij projekti, nxënësve romë dhe egjiptianë të klasave të 9-ta po u shpërndahen 80 bursa sociale (30 euro/muaj për çdo nxënës të përzgjedhur, 300 euro/vit).

*Rekomandimi 21. Ratifikimi i Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara*

149. Në lidhje me ratifikimin e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, kjo konventë u ratifikua nga Shqipëria në vitin 2012.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2017

Adresa: Rr "Nikolla Jorga", Tiranë  
Tel/fax +355 4 24 27 004 Tel +355 4 24 27 006

Çmimi 252 lekë